

# Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit në Kosovë (ARRU)

## Dokument konsultimi për politikën e ardhshme tarifore të shërbimeve të ujit

Janar 2024

Data e publikimit:	24.01.2024
Faqja për shkarkim	<a href="http://www.arru-rks.org">www.arru-rks.org</a>
Afati i përgjigjeve:	12.02.2024
Kontakti:	<a href="mailto:Lule.Aliu@arru-rks.org">Lule.Aliu@arru-rks.org</a>
Telefoni:	038 200 62 900
Dërgoni përgjigjet në:	<a href="mailto:info@arru-rks.org">info@arru-rks.org</a>

# Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit në Kosovë (ARRU)

## Konsultimet për politikën e ardhshme tarifore të shërbimeve të ujit

Janar 2024

### Konteksti

#### Detyrat

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit të Kosovës (ARRU) është rregullatori ekonomik për shërbimet e furnizimit me ujë dhe ujërave të ndotura në Kosovë. Përveç tjerash ARRU rregullon tarifën e aplikuar nga shtatë kompanitë rajonale të ujit (KRU-të) dhe furnizimin me ujë me shumicë nga Ibër Lepenci. Ky dokument konsultimi kufizohet në rregullimin e tarifave të aplikuar nga KRU-të.

Përgjegjësitë e ARRU janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit. Legjislacioni tjetër relevant përfshin:

- Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës
- Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike
- Udhëzimin Administrativ për Cilësinë e Ujit për Konsum nga Njeriu 10/2021

Parimi kryesor i ARRU-së në zbatimin e detyrave rregullatore është që të sigurojë se KRU-të mund të mbledhin të ardhura të mjaftueshme për të financuar siç duhet aktivitetet e tyre në përputhje me obligimet ndaj nivelit të shërbimit, që janë të balancuara kundrejt të siguruarit që konsumatorët nuk paguajnë më shumë se sa që është e nevojshme dhe që konsumatorët e cenusëm janë të mbrojtur në mënyrë adekuate. Në vendimmarrjen tonë ARRU merr parasysh edhe ndikimet në ekonominë, mjedisin dhe shoqërinë më të gjerë.

#### Historia

Ligji për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit kërkon nga ARRU që të zhvillojë rregulla për përcaktimin e tarifave. Që nga viti 2009 ARRU ka vendosur tarifa në baza tre-vjeçare, më e fundit prej të cilave është përfunduar në dhjetor 2021 për periudhën 2022 – 2024 <sup>1</sup>.

Rishikimi i parë tre-vjeçar (2009 – 2011) ishte një proces relativisht i thjeshtë prej të cilit më pas u zhvillua një model dhe proces më i fuqishëm për periudhën 2012 – 2014. Ky model i dytë është shabllon për rishikimet pasuese të tarifave të ARRU-së. Megjithatë janë bërë disa përmirësime të vogla, modeli më i fundit është praktikisht i pandryshuar nga formati origjinal.

Arsyeja për një proces tre-vjeçar ishte që të inkurajohen KRU-të që të kenë një perspektivë më afatgjatë të aktiviteteve të tyre të ardhshme dhe t'u jepet atyre siguri se tarifën duhet të jenë të mjaftueshme për t'i financuar ato. Aplikimet për tarifa të dorëzuara në ARRU për të mbështetur përcaktimet tona përfshinin një plan të detajuar biznesi. Kjo përfshiu objektiva specifike operative dhe financiare në lidhje me pritjet për përmirësim të efikasitetit. KRU-të mund të rrisin rentabilitetin e tyre nëse mund t'i tejkalojnë këto objektiva. Duke vendosur tarifën në baza tre-vjeçare, KRU-të mund të gëzonin përfitimet e tyre shtesë për një periudhë më të gjatë përpara se kostot dhe nivelet e performancës në fund të periudhës së rishikimit të bëheshin bazë për periudhën e ardhshme të rishikimit të tarifave. Një periudhë tre-vjeçare e rishikimit ofron mekanizma nxitës për KRU-të që të tejkalojnë objektivat e tyre. Ky është koncepti themelor i 'mekanizmi rregullator nxitës'.

Modeli tre-vjeçar përbëhet nga një shabllon i planit të biznesit për ekipet rregullatore të KRU-ve të cilat duhet ta plotësojnë atë dhe përfshin projeksionet e numrit të konsumatorëve, kërkesat, shitjet e ujit, ujërat e ndotura të gjeneruara, performancën operative dhe komerciale dhe përmirësimin e efikasitetit dhe investimet. Më pas ai përcakton të ardhurat nga tarifën të cilat janë të nevojshme për të përmbushur këto nivele të parashikuara të performancës.

<sup>1</sup>Tarifat për vitin 2021 u përcaktuan në një përshtatje kundrejt inflacionit nga vitet e mëparshme. Një rishikim i plotë tre-vjeçar gjatë vitit 2020 nuk ishte i mundur për shkak të rregullimeve që rezultuan si pasojë e Covid 19.

ARRU gjithashtu është përgjegjës për monitorimin e performancës. Sistemi fillestar i monitorimit të performancës ishte trashëguar nga sistemi i Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) e cila ishte krijuar para themelimit të Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (emri i mëparshëm i ARRU-s). Me prezantimin e procesit të tarifave trevjeçare, korniza e monitorimit të performancës u ndryshua rrënjësisht për të pasqyruar matjen e performancës së KRU-ve kundrejt objektivave të tyre, siç është përcaktuar në aplikacionet e tyre tarifore.

Si pjesë e raportimit të performancës dhe si ndihmë për modelet tarifore, ARRU krijoi një kornizë rregullatore të kontabilitetit, udhëzimet e kontabilitetit rregullator (UKRR), e cila regjistron transaksionet financiare që mund të krahasohen me modelin tarifor. UKRR dallon nga kontabiliteti konvencional në mënyrën se si e trajton vlerën e asetëve (BRRA), zhvlerësimin dhe aspekteve të tjera të nevojshme për përcaktimet e duhura të tarifave.

## Rezultatet

Fillimisht KRU-të i panë planin e biznesit dhe modelet tarifore si të ndërlikuara dhe të vështira për t'u kuptuar. Përgjatë viteve ARRU ka ofruar mbështetje të gjerë për KRU-të në përfundimin e aplikacioneve të tyre. Pas pesë proceseve tarifore, KRU-të tani kanë një kuptim më të madh të kornizës tarifore megjithëse në disa raste konceptet si baza rregullatore e asetëve dhe përtëritja e infrastrukturës ende nuk janë kuptuar plotësisht nga të gjithë.

Përkundër kësaj, regjimi i përcaktimit të tarifave ka rezultuar të jetë mjaft i fuqishëm dhe ka mirëmbajtur integritetin financiar të KRU-ve, në veçanti kthimi në bazën rregullatore të asetëve (BRRA) që ka mbrojtur rrjedhën e parave të KRU-ve, madje edhe kur ato marrin kredi afatshkurtra për investime.

Performanca është përmirësuar në disa fusha, por në shumë raste përmirësimi i performancës nuk i ka përmbushur pritshmëritë, veçanërisht në fushat e tilla si efikasiteti i shpenzimeve operative dhe aktivitetet komerciale (arkëtimi i të ardhurave). Shumica e objektivave të përmirësimit të efikasitetit të përcaktuara në planet e biznesit nuk janë arritur në vazhdimësi pothuajse nga të gjitha KRU-të.

Gjatë pesë proceseve tarifore, BRRA është rritur në mënyrë të qëndrueshme në terma realë për të gjitha KRU-të edhe pse jo aq sa do të kishim shpresuar, veçanërisht në sektorin e ujërave të ndotura. Planet e biznesit gjithmonë kanë përfshirë një element të rëndësishëm të investimeve kapitale, por në fund të çdo rishikimi trevjeçar shumë pak nga ky investim u materializua. Në fakt, konsumatorët kanë paguar për investime të cilat nuk kanë ndodhur kurrë dhe mund të argumentohet se atyre duhet t'u rikthehen paratë. Analiza e ARRU sugjeron se këto të ardhura të pajustificuara janë kompensuar nga dështimi i KRU-ve për të ofruar përfitimet e pritshme të efikasitetit operacional.

Shkaku i këtij dështimi është një spirale në rënien e performancës së ulët:

- KRU-të nuk i përmbushin objektivat e efikasitetit komercial (arkëtimi i të ardhurave) duke çuar në të ardhura në para më pak se sa ishte planifikuar.
- Ato gjithashtu nuk i arrijnë objektivat e efikasitetit të shpenzimeve operative duke çuar në shpenzime më të larta se sa ishte planifikuar.
- Paraja e mbetur atëherë është e pamjaftueshme për të përmbushur shpenzimet e planifikuara të investimit.
- Më pastaj BRRA është më e ulët se sa ishte planifikuar, gjë që redukton tarifën për procesin e ardhshëm trevjeçar në krahasim me ato që do duhej të ishin.

ARRU ka për detyrë të mbrojë integritetin financiar të KRU-ve edhe përkundër pakënaqësisë lidhur me punën e tyre të dobët, ne kemi qenë të kujdesshëm në mënyrën se si të përgjigjemi. ARRU kishte mundur, teorikisht, të tërhiqte paratë që ishin dhënë përmes tarifave për investime nëse ai investim nuk do të ndodhte duke ulur kërkesën për të ardhura në procesin e ardhshëm tarifor. Kjo është qasja konvencionale rregullatore kur shërbimet e ujit janë në pronësi të sektorit privat dhe veprimet e tilla do të rezultojnë në ulje të fitimeve dhe dividendave. Për KRU-të në pronësi të shtetit, ku nuk jepen dividenda për aksionarët, kthimi i rezervave të pashpenzuara për investime mund të ketë një ndikim negativ në integritetin e tyre financiar dhe kështu do ta përkeqësonte edhe më tej gjendjen e shërbimeve të ujit.

Kjo vendos ARRU-në në një pozicion të rrezikut moral. Duke mos kërkuar të rikuperojnë mjetet e pashpenzuara për investime, KRU-të trimërohen që të vazhdojnë të përfshijnë investime në planet e tyre me objektivin e rritjes së tarifave, por që më pas të mos realizojnë investime të tilla.

Rrjedhimisht, reagimet e sjelljes që ishin pritur përmes kësaj qasjeje të 'mekanizmit rregullator nxitës' nuk ishin materializuar plotësisht. Në disa aspekte, kjo ka pasur efekt të kundërt dhe në vend që të sillen si ndërmarrje komerciale efikase, KRU-të shfaqin karakteristikat e monopoleve të pakufizuara dhe u kushtojnë vëmendje të kufizuar vendimeve, udhëzimeve dhe masave rregulatore detyruese.

Në raportet vjetore të performancës, ARRU ka qortuar rregullisht KRU-të për dështimin e tyre në arritjen e objektivave, dhe megjithëse atyre mund të mos u pëlqej ajo që shkruhet për performancën e tyre të dobët, nuk ka qenë e mjaftueshme që të stimulohen për të bërë përmirësime domethënëse.

ARRU duhet të forcojë ndikimin mbi KRU-të për të ofruar nivelin e performancës, efikasitetit dhe investimeve që janë të përfshira në planet e biznesit të KRU-ve.

Performanca e dobët shtrihet edhe në cilësinë e aplikacioneve të dorëzuara, e cila është ende nën nivelin e prithshmërive të ARRU-së. ARRU vazhdon me përpjekje të konsiderueshme duke i ndihmuar KRU-të në shumë çështje, të cilat lidhen me të dhënat jo të plota, mospërputhshmëritë dhe në përgjithësi me planet e dizajnuara në mënyrë të dobët.

## Nevoja për një rishikim madhor

Deri në përfundimin e periudhës tjetër të procesit tarifor (31 dhjetor 2024), sistemi aktual mbush 16 vjet që është në fuqi. Përkundër modifikimeve dhe përmirësimeve të vogla, korniza është kryesisht e njëjtë me atë që ishte 16 vjet më parë. ARRU konsideron se një rishikim domethënës i kornizës së përgjithshme me synimin që të zhvillohet një strukturë rregulatore e përmirësuar për të ardhmen është shumë e vonuar.

Ky rishikim adreson mangësitë e përshkruara më lart, në veçanti nevojën për të siguruar që KRU-të të arrijnë nivelet e performancës, efikasitetit dhe investimeve që ata thonë se mund t'i arrijnë në planet e tyre të biznesit.

Ky dokument konsultimi paraqet propozimet për një rishikim të rëndësishëm të nivelit të lartë të kornizës rregulatore. Dokumenti paraqet disa fusha ku ARRU beson se kërkohet ndryshim, analizën e problemeve, propozime si dhe ndikimet e tyre aty ku është e mundur dhe e përshtatshme. ARRU shqyrton këndvështrime dhe opsione, gjithmonë 'e prirur' për të gjetur opsionin më të favorshëm.

Ky konsultim bëhet për të kërkuar pikëpamjet e palëve të ndryshme, të interesuara për të drejtuar vendimmarrjen rregulatore në të ardhmen. Konsultimi iu drejtohet shumë palëve të interesit, përfshirë, por pa u kufizuar në:

- Qeverinë.
- KRU-të.
- Grupet e konsumatorëve shtëpiak.
- Grupet e konsumatorëve jo shtëpiak.
- Investitorë, veçanërisht partnerë ndërkombëtarë të zhvillimit.
- Akademinë.
- Palët e tjera të interesuara.

## Udhëzimet e konsultimit

---

ARRU në këtë dokument ka listuar ndryshimet e propozuara të metodologjisë tarifore, duke dhënë një arsyeshmëri të ndryshimeve të propozuara, një përshkrim për përparësitë dhe si do të reflektohet në tarifë ndryshimi i propozuar.

Për të qenë më e lehtë për audiencën (publikun), ky dokument konsultues ka pjesën e marrjes së përgjigjeve nga palët e interesit, që janë dhënë të gatshme në formë opsionesh që duhet të përzgjidhen nga të anketuarit.

Për të qenë gjithëpërfshirës, dokumenti për konsultim (dhe për marrje të opinionit) do t'ju dërgohet të gjitha palëve të interesit të involvuara në sektorin e ujit. Veç kësaj, ky dokument do të jetë në disponim të gjithë të interesuarve për të kontribuar në këtë çështje dhe mund të zbritet nga web-faqja e ARRU-së dhe të 7 KRU-ve. Dokumenti do të publikohet më datë 24.01.2024, ndërsa përgjigjet dhe kontributi i secilit pritet të arrijnë në ARRU (qoftë në formë fizike apo elektronike) para datës 12.02.2024 me fund të orarit të punës të kësaj dite.

## Dokumentet shoqëruese

---

Legjislacioni:

- Ligji Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit.
- Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës
- Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike
- Udhëzim Administrativ për Cilësinë e Ujit për Konsum nga Njeriu 10/2021

Instrumentet rregullatore:

- Politikat tarifore e ARRU-s
- Procedurat e ARRU-s për Përcaktimin e Tarifave
- Biznes Plani Rregullator dhe modeli tarifor i ARRU-s (përfshirë doracakët shoqërues)
- Udhëzuesit e kontabilitetit rregullator të ARRU-s (UKRR)
- Raportet e ARRU-s të monitorimit të performancës.
- Licencat e KRU-ve.

## Përmbajtja

Konteksti .....	i
Udhëzimet e konsultimit.....	iii
Dokumentet shoqëruese.....	iv
1 Parimet e tarifave të furnizimit me ujë dhe ujëra të ndotura .....	1
2 Mbulimi i kostos – stimujt për përmirësimin e efikasitetit operacional .....	8
3 Mbulimi i kostos – nxitja aktuale për shtyrjen e përmirësimeve të efikasitetit .....	11
4 Mbulimi i kostos – investimi kapital.....	13
5 Mbulimi i kostos - aplikacionet e planeve të biznesit me cilësi të dobët .....	17
6 Kosto reflektive – heqja graduale e ndërsuvencionimit aktual .....	19
7 Kosto reflektive - zëvendësimi i tarifave fikse mujore me një tarifë të bazuar në madhësinë e gypit të lidhjes .....	23
8 Kosto reflektive – tarifat për përforcimin e infrastrukturës në largësi.....	25
9 Kosto reflektive – tarifat e vlerësuara të ujërave të ndotura.....	29
10 Kosto reflektive– tarifat e ujërave të ndotura bazuar në vëllimin dhe cilësinë e shkarkimeve të ujërave të ndotura .....	30
11 Mbrojtja e konsumatorëve të cenueshëm .....	34

## 1 Parimet e tarifave të furnizimit me ujë dhe ujëra të ndotura

### 1.1 Parimi gjithëpërfshirës

1.1 Neni 4 (paragrafi 3.2) i *Ligjit për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit* definon rolin e ARRU në përcaktimin e tarifave si:

*3.2. përcaktimin e tarifave të shërbimit për ofruesit e shërbimeve, duke siguruar që tarifat të jenë të drejta dhe të arsyeshme dhe të mundësojnë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve;*

1.2 ARRU e interpreton këtë si balancim të nevojave të konsumatorëve dhe të ofruesve të shërbimeve duke siguruar që KRU-të të kenë të ardhura të mjaftueshme për të financuar aktivitetet e tyre në përputhje me detyrimet e tyre statutorë, por në të njëjtën kohë që të inkurajohen ato që të jenë sa më efikase. Kjo do të sigurojë që tarifat të jenë sa më të ulëta që është e mundur.. ARRU është e prirur që konsumatorët të mos financojnë jo efikasitetin e KRU-ve.

1.3 ARRU ka interpretuar detyrimin e saj për të zhvilluar politikat tarifore , procedurat dhe modelet tarifore, bazuar në kostot e parashikuara, përfshirë pritshmëritë e arsyeshme dhe të arritshme për përmirësim të efikasitetit dhe investimet e ardhshme kapitale, së bashku me pritshmëritë lidhur me konsumin e ujit dhe ujërat e ndotura të shkarkuara.

1.4 ARRU konsideron se ky interpretim i gjerë i detyrimit mbetet i vlefshëm dhe nuk kërkohet ndryshim i këtij parimi.

### 1.2 Mbulimi i kostos

#### Qasja aktuale dhe arsyetimi ekonomik

1.5 Është detyrim ligjor i ARRU-së të sigurojë që ofruesit e shërbimeve mund të financojnë aktivitetet e tyre. Kjo shpesh interpretohet si përmirësim dhe 'mbulimi i kostos'. Megjithatë, shprehja 'mbulim i kostos' në sektorin e ujit është subjekt i përkufizimeve të ndryshme, ku secili ka të metat e tij të ndryshme, p.sh.

- **Përkufizimi i thjeshtë i kontabilitetit:** Fitimi dhe humbja dalin bars, por me cilat standarde të kontabilitetit, kontabiliteti tatimor, kontabiliteti komercial e të tjera? Si përfshihet zhvlerësimi, historik (bazuar në çmimin fillestar të blerjes) apo rivlerësohet për të marrë parasysh inflacionin etj.?
- **Rrjedha e parasë :** Rrjedha pozitive e parasë apo kostoja kufizohet në të ardhura? Si të llogariten provizionimi i llogarive të arkëtueshme?
- **Përmirësimi dhe pritshmëritë të investitorëve:** Cilat janë këto pritshmëri? Sa është vlera e kapitalit të investuar? Cilat raporte financiare duhet të aplikohen?
- **Kostot aktuale apo siç duhet të jenë:** Çfarë duhet të jenë ato dhe si të përcaktohen pritshmëritë reale për efikasitetin e përmirësuar?

1.6 Parimi drejtues i ARRU-së është se në sektorin e ujit të Kosovës, 'mbulimi i kostos' nënkupton një rrjedhë të ardhurash që është e mjaftueshme për ofruesit e shërbimeve që t'i financojnë aktivitetet e tyre, përfshirë investimet, që janë të nevojshme , për të ofruar shërbime sipas detyrimeve ligjore.

1.7 Kjo rrjedhë e të ardhurave mund të përbëhet nga grante, subvencione dhe burime të tjera me balancën që vjen nga tarifat.

1.8 Aktualisht, të ardhurat e kërkuara përbëhen nga tre elementë kryesorë:

- Kostot e parashikuara operative (përfshirë pritshmëritë për efikasitetin e përmirësuar)
- Shpenzimet e parashikuara për mirëmbajtjen kapitale (të përbërë nga investimet e pritshme në përtëritjen e infrastrukturës dhe zhvlerësimi i kostos aktuale)
- Kthimi në bazën rregullatore të aseteve.

- 1.9 Modeli tarifor përcakton këto kosto në bazë të një analizë rigoroze të aplikacioneve të KRU-ve. Pas lejimit të të ardhurave nga burime të tjera, modeli pastaj përcakton tarifat e nevojshme për përmbushjen e kësaj kërkesë të të ardhurave.
- 1.10 Në shqyrtimin me kujdes të aplikacioneve të KRU-ve, ARRU sfidon propozimet e tyre për efikasitet të përmirësuar me ato që beson se janë objektiva sfiduese të performancës, por megjithatë të arritshme. Kjo përfshin reduktimet në kostot operative ku ARRU beson se ato janë më të larta se sa duhet. ARRU e bën këtë përmes analizës krahasuese të performancës së shtatë KRU-ve duke përdorur performancën më të mirë si një matës që të tjerët të mund të arrijnë. ARRU merr në konsideratë karakteristikat specifike të KRU-ve individuale, p.sh. kostot e energjisë të cilat nuk mund të krahasohen dhe të përdoren si matës. Përkundër përpjekjeve për të promovuar efikasitetin e përmirësuar operacional, KRU-të i kanë huq këto objektiva. ARRU beson se korniza tarifore duhet të ndryshohet, për të ofruar stimuj për KRU-të që të arrijnë dhe madje edhe të tejkalojnë objektivat e paraqitura në planet e tyre të biznesit.
- 1.11 Procesi i përcaktimit të tarifave bazohet në projeksione dhe përcakton tarifat për tre vjet. ARRU i lejon KRU-të të ruajnë përfitimet e performancës që tejkalojnë pritshmëritë financiare brenda ciklit tre-vjeçar, por më pas kjo performancë e lartë reflektohet në parashikimet e ardhshme të kostos në dobi të konsumatorëve. Kjo ofron një nxitje të kufizuar në kohë për KRU-të që të përmirësojnë efikasitetin dhe për të ruajtur nivelet e efikasitetit të tillë apo edhe më të mirë më pas. ARRU e pret se ky proces mund të rezultojë në një reagim të çoroditur të sjelljes në atë që KRU-të do të dekurajohen nga fillimi i një aktiviteti për përmirësimin e efikasitetit në periudhën e mëvonshme brenda ciklit tre-vjeçar, pasi që ato do të gëzojnë përfitimin për më pak se tre vjet. Ato mund të zgjedhin të shtyjnë nismën për përfitimin nga efikasiteti deri në fillimin e procesit të ardhshëm rregullator. Rregullatorët e tjerë, gjatë në botë, janë përballur me të njëjtën çështje dhe e kanë adresuar atë duke përfshirë në modelet e tyre një veçori që lejon që përfitimet e efikasitetit të gëzohen për një periudhë të plotë të procesit rregullator, pavarësisht kohës se kur u realizuan përfitimet për herë të parë gjatë një procesi duke i kaluar përfitimet si shtesë në kërkesën për të ardhura në procesin vijues, p.sh. nëse ofruesi i shërbimit realizon një përfitim të efikasitetit në fillim të vitit të tretë, atëherë përfitimi vjetor do t'i shtohet kërkesës së të ardhurave për vitin një dhe dy të procesit vijues. Kjo i inkurajon KRU-të që të iniciojnë përfitimet e efikasitetit sapo që ato të identifikohen për herë të parë me besimin se do të gëzojnë përfitimet për tre vjet. Kjo do të rezultojë në kalimin e përfitimeve të efikasitetit tek konsumatorët më herët sesa ato do të paraqiteshin.
- 1.12 Procesi i përcaktimit të tarifave merr parasysh investimet kapitale në dy kategori të gjera:
- Mirëmbajtja kapitale: riparimi ose zëvendësimi i madh i aseteve në fund të jetës së tyre të dobishme për të ruajtur, por jo edhe për të tejkaluar nivelet e shërbimit të nivelit bazë, dhe
  - Rritja kapitale: investimi i nevojshëm për të përmbushur kërkesën shtesë dhe/ose nivelet e përmirësuara të shërbimit.
- 1.13 Megjithëse planet e biznesit kanë përfshirë investime të konsiderueshme në mirëmbajtjen dhe rritjen e kapitalit, disa KRU vazhdimisht kanë dështuar të realizojnë investimin të cilin e kanë premtuar. Në teori, konsumatorët kanë paguar për investim i cili nuk ka ndodhur dhe ARRU konsideron se ata kanë të drejtën që t'u kthehen paratë. Në anën tjetër, ARRU ka për detyrë të mbrojë integritetin financiar të KRU-ve edhe përkundër pakënaqësisë për performancën e tyre të dobët, ARRU ka qenë të kujdesshëm në mënyrën se si reagojmë. ARRU mund, teorikisht, të kthejë paratë që ishin dhënë për investimin përmes tarifave nëse ai investim nuk ka ndodhur duke zvogëluar kërkesën për të ardhura në procesin e ardhshëm tarifor. Kjo është qasja konvencionale rregullatore kur shërbimet e ujit janë në pronësi të sektorit privat dhe veprimet e tilla do të rezultojnë në ulje të fitimeve dhe dividendave. Për KRU-të në pronësi të shtetit ku nuk jepen dividenda për aksionarët, kthimi i parave për investimet e pa realizuara mund të ketë një ndikim negativ në integritetin e tyre financiar dhe ta përkeqësojë më tej gjendjen në shërbimet e ujit.
- 1.14 Kjo vendos ARRU-në në një pozicion të rrezikut moral. Duke mos kërkuar të rikuperojnë mjetet e pashpenzuara për investime, KRU-të trimërohen që të vazhdojnë të përfshijnë investime në planet e tyre me objektivin e rritjes së tarifave, por që më pas të mos realizojnë investimet e tilla.



- 1.15 Përkundër rrezikut të mundshëm të imponimit të presioneve financiare në KRU-të, ARRU beson se kjo gjendje nuk mund të vazhdojë pafundësisht dhe duhet të korrigojë në rishikimet e ardhshme të tarifave.
- 1.16 Konkluzioni ynë është se aplikacionet tarifore të KRU-ve janë bërë bazuar në synimin e kufizuar për respektimin e zotimeve të tyre të deklaruara. ARRU konsideron se aplikacionet janë të dizajnuara për të maksimizuar të ardhurat duke përfshirë investimet kapitale të cilat nuk janë zotuar dhe komponenti financiar i kërkesës për të ardhura për këto shpenzime përdoret për të shtyrë përmirësimet në efikasitetin operacional. ARRU konsideron se mund të nevojiten veprime për të stimuluar cilësinë e aplikacioneve të planeve të biznesit për t'u siguruar që ato janë zhvilluar në mënyrë profesionale dhe se jemi të bindur që ato do të pasqyrojnë aktivitetet aktuale të KRU-ve.

#### Ndryshimet e propozuara

- 1.17 ARRU po shqyrton një ndryshim të përcaktimit të kërkesës për të ardhura për të përfshirë aspekte të tjera duke përfshirë:
- Përfshirjen mekanizma nxitës që të përmbushen objektivat e performancës.
  - Një përshtatje të modelit për të kaluar përfitimet e efikasitetit nga një cikël rregullator në tjetrin dhe për të inkurajuar miratimin e hershëm të përmirësimeve të efikasitetit.
  - Një përshtatje për të rikuperuar disa ose të gjitha rezervat e kaluara për investime kapitale ku investimi i planifikuar nuk është ndërmarrë (kjo përfshin shpenzimet për përtëritjen e infrastrukturës dhe zhvlerësimin plus kthimi në kapital për përmirësimin e infrastrukturës dhe investimet jo-infrastrukturore).
  - Stimuj financiarë për përmirësimin e cilësisë së aplikacioneve tarifore.
- 1.18 Këto aspekte janë përshkruar në më shumë detaje në seksionet 2deri në 5të këtij dokumenti të konsultimit.

### **1.3 Kostoja reflektive**

#### Qasja aktuale dhe arsyetimi ekonomik

- 1.19 Megjithëse tarifat e furnizimit me ujë dhe ujërat e ndotura përmbushin objektivat e mbulimit të koston, ARRU nuk i konsideron tarifat si kosto reflektive. Kosto reflektive është arritur pjesërisht përmes ndarjes së kostove ndërmjet shërbimeve të furnizimit me ujë dhe ujërave të ndotura, por brenda këtyre dy shërbimeve bazë tarifat nuk janë kosto reflektive. Politika e tarifimit në mënyrë substanciale më e lartë për konsumatorët jo-shtëpiak se sa për konsumatorët shtëpiak nuk mbështetet nga asnjë dëshmi se konsumatorët jo shtëpiak imponojnë kosto më të larta se konsumatorët shtëpiak për KRU-të. Kjo është një politikë që ka ekzistuar prej shumë kohësh e shtyrë nga perceptimet e kufizimeve të përballueshmërisë.
- 1.20 Provizioni për ujë është një produkt uniform për të cilin tarifa uniforme është racional. E njëjta gjë nuk mund të thuhet për ujërat e ndotura ku cilësia e ujërave të ndotura mund të ketë ndikim material në kostot e trajtimit të ujërave të ndotura. Politika jonë aktuale është që konsumatorët jo-shtëpiak paguajnë tarifa në mënyrë substanciale më të larta se konsumatorët shtëpiak për shërbimet e ujërave të ndotura. Në vend që të reduktohet gradualisht ndër-subvencionimi me kalimin e kohës, siç është aplikuar për tarifat e furnizimit me ujë, ndërsbvencionimi për tarifat e ujërave të ndotura është praktikisht i pandryshuar gjatë 15 viteve të fundit ose më gjatë. Kjo është bazuar në supozimin se ujërat e ndotura jo-shtëpiake mund të jenë më ndotëse se ujërat e ndotura shtëpiake. Tani besojmë se ky supozim mund të mos jetë aq i fortë se sa mendohej fillimisht. Për shumicën e konsumatorëve jo-shtëpiak (dyqane, qendra tregtare, zyra, institucione arsimore dhe më tepër) nuk ka asnjë arsye për të besuar se ujërat e ndotura të tyre do të jenë më ndotëse sesa ujërat e ndotura shtëpiake.
- 1.21 Megjithatë, ka disa konsumatorë jo-shtëpiak ku cilësia e ujërave të tyre të ndotura është në mënyrë materiale më ndotëse sesa ujërat e ndotura shtëpiake. ARRU beson se këta konsumatorë nuk duhet të paguajnë të njëjtat tarifa si homologët e tyre më pak ndotës dhe tarifat e bazuara në cilësinë e ujërave të ndotura si dhe në vëllim mund të jenë të garantuara.

1.22 Teoria ekonomike thotë se efikasiteti ekonomik (shpërndarja optimale e burimeve) maksimizohet kur mallrave dhe shërbimeve u caktohet çmimi me koston e prodhimit. Për furnizimin me ujë, kjo do të thotë që nëse shërbimi ka një çmim mbi koston e prodhimit për disa konsumatorë (jo shtëpiak) konsumatori konsumon më pak se sa është ekonomikisht praktike dhe anasjelltas. Për konsumatorët e biznesit në veçanti këto tarifa më të larta kontribuojnë në kosto më të larta në zinxhirin e tyre të vlerës, gjë e cila mund të ndikojë negativisht në konkurrencën e tyre dhe të jetë një pengesë për ekonominë e gjerë. Konsumatorët jo-shtëpiak mund të përdorin më pak ujë sesa përndryshe do të përdornin. Kjo ka të njëjtin efekt sikur të ishte një taksë për biznesin e tyre. Në rastin ekstrem, disa biznese më të mëdha mund ta marrin në konsideratë vetë-furnizimin përmes puseve me një kosto më të ulët se sa furnizimi nga KRU-të, një vendim të cilin ata mund të mos e arrijnë nëse tarifat do të ishin të bazuara në kosto reflektive. Këto reagime të sjelljes rezultojnë në një humbje të të ardhurave për KRU-në dhe për të mirëmbajtur e kërkesën për të ardhura, tarifat do të duhet të rriten për të gjithë konsumatorët e tjerë. Nga ana tjetër, uji për konsumatorët shtëpiak është me tarifa nën koston e prodhimit dhe realizimit (humbjeve). Prandaj, konsumatorët shtëpiak mund të përdorin më shumë sesa do të përdornin duke i përkeqësuar kështu humbjet e ofruesit të shërbimit.

1.23 Humbjet si për konsumatorët ashtu edhe për ofruesit e shërbimeve duke devijuar nga tarifat me kosto reflektive referohen nga ekonomistët si *'humbje e peshës së vdekur (humbja ndërmjet prodhimit dhe konsumit!)*' (shih Figurën Figura 1Figurën Figura 2. Politikë e ARRU-së ka qenë të inkurajojë KRU-të që të zvogëlojnë shkallën e ndërsbvencionimit me kalimin e kohës për të reduktuar këto *'humbje të peshës së vdekur (humbja ndërmjet prodhimit dhe konsumit!)*' në dobi të konsumatorëve, KRU-ve dhe ekonomisë më të gjerë. Fatkeqësisht, progresi në këtë fushë ka qenë shumë i ngadaltë.




Figura 1– Teoria ekonomike, *'humbja e peshës së vdekur'* (ndërmjet prodhimit dhe konsumit!) për konsumatorët komercialë




Figura 2– Teoria ekonomike, *'humbja e peshës së vdekur'* (ndërmjet prodhimit dhe konsumit!) për konsumatorët shtëpiak

1.24 Ndërsbvencionimi përshihet në komponentin e tarifave fikse mujore. Këto tarifa fikse normalisht do të mbulonin kostot që nuk lidhen me vëllimin, përfshirë leximin e ujëmatësve, faturimin, mbledhjen e

të ardhurave, kostot e zëvendësimit të ujëmatësve dhe kostot e tjera të ndryshme. Tarifat aktuale mujore fikse për konsumatorët jo shtëpiak janë dyfishi i tarifave fikse të konsumatorëve shtëpiak. ARRU nuk sheh asnjë arsye financiare për të mbështetur dallimet e tilla për konsumatorët me lidhje të madhësisë së ngjashme (të diametrit të gypit). ARRU e pranon se konsumatorët me lidhje më të mëdha mund të kenë kosto më të larta jo-vëllimore, kryesisht për shkak të zëvendësimit periodik të njehsorit. ARRU konsideron se kjo nuk është as kosto reflektive dhe as nuk është e drejtë që një biznes i vogël me një lidhje prej 15 mm duhet të paguajë të njëjtën tarifë fikse si një konsumator i madh industrial me, të themi, një lidhje prej 100 mm. ARRU konsideron se heqja e ndër-subvencionimit të tarifës fikse dhe zëvendësimi i tij me një plan tarifor fiks të bazuar në lidhjen ose madhësinë e njehsorit do të ishte më shumë kosto reflektive.

- 1.25 Aplikimi i tarifave sipas koston reflektive për shërbimet e furnizimit me ujë dhe ujëra të ndotura duhet të bëhet me një qasje të balancuar kundrejt praktikave më të lehta të aplikueshme në terren. Vendosja e tarifave bazuar në mesataren midis konsumatorëve dhe grupeve të konsumatorëve është shpesh qasja më praktike, përveç nëse ka prova të qarta që disa konsumatorë ose grupe të caktuara konsumatorësh, në fakt, imponojnë kosto dukshëm më të larta ose më të ulëta në sistemet e ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura, p.sh. shkarkimet e ujërave të ndotura industriale që janë ndotëse në masë të lartë.
- 1.26 Një fushë tjetër shqetësuese është rritja e shpejtë e numrit të banesave viteve të fundit. Megjithëse infrastruktura e lokalizuar për një zhvillim të ri paguhet nga ndërtuesit, një zhvillim i tillë imponon kosto për KRU-të që nuk lidhen drejtpërdrejt me lokacionin e banesave të ndërtuara, p.sh. sforcimi i rrjetit në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme për ujë dhe ujëra të ndotura, përkatësisht. Ndonëse këto kosto u imponohen KRU-ve nga aktivitetet e ndërtuesve, ato barten nga të gjithë konsumatorët brenda tarifës. ARRU nuk është e bindur që konsumatorët ekzistues duhet të përballojnë kostot e përfundimit të rrjetit të nxitura nga kërkesat shtesë që vijnë nga konsumatorët e rinj.
- 1.27 Marrëveshja aktuale për tarifën e ujërave të ndotura është që tarifa bazohet në një shkallë për njësi të furnizimit me ujë të ofruar. Kjo është e vlefshme për shumicën dërrmuese të konsumatorëve. Megjithatë, ARRU ka vënë re se mund të ketë disa industri të cilat shkarkojnë ujërat e ndotura në rrjetet e ujërave të ndotura, por uji i tillë nuk sigurohet nga KRU-të, p.sh. nga pusët vetjake etj. ARRU konsideron se konsumatorët e tillë duhet të paguajnë për shërbimet e tyre të ujërave të ndotura në një vëllim të vlerësuar ose të matur të shkarkimit të ujërave të ndotura në krahasim me hyrjen e ujit të KRU-së.

#### Ndryshimet e propozuara

- 1.28 Për të përmirësuar koston reflektive dhe rrjedhimisht efikasitetin ekonomik, ARRU po shqyrton ndryshimet në metodën e përcaktimit të tarifave për të përfshirë:
- Përshejtimin e zvogëlimit të ndërsubvencionimit aktual nga konsumatorët jo-shtëpiak tek ata shtëpiak (si për shërbimet e furnizimit me ujë ashtu edhe për shërbimet e ujërave të ndotura).
  - Heqja e ndërsubvencionimit në tarifën fikse dhe zëvendësimi me një plan tarifash të bazuar në lidhjen dhe madhësinë e ujëmatësit.
  - Futja e tarifave të ujërave të ndotura të bazuara në cilësi për konsumatorët e veçantë ku ka një ndryshim material në cilësinë e ujërave të ndotura.
  - Aplikimi i taksës për zhvillimin e infrastrukturës për ndërtuesit si një kontribut në kostot e sforcimit të rrjetit në largësi, që konsiderohet i nevojshëm si rezultat i rritjes së kërkesës për shkak të rritjes së numrit të banesave dhe zhvillimit komercial.
  - Tarifën e ujërave të ndotura për ata përdorues, ujërat e ndotura të cilëve merren nga burime që nuk i përkasin KRU-ve, do t'i nënshtrohen tarifave të vlerësuara.
- 1.29 Këto aspekte janë përshkruar më tepër në detaje në seksionet 6deri në 10të këtij dokumenti të konsultimit.

## 1.4 Mbrojtja e konsumatorëve të cenueshëm

### Qasja aktuale dhe arsyetimi ekonomik

- 1.4.1 Tarifat për konsumatorët jo-shtëpiak për shërbimet e ujit janë aktualisht 1.5 herë sa tarifat për konsumatorët shtëpiak, ndërsa për shërbimet e ujërave të ndotura janë 2.2 herë tarifat për konsumatorët shtëpiak. Në përputhje me politikën tarifore të ARRU-së dhe për të promovuar një efikasitet më të madhe ekonomike ARRU beson se është e nevojshme një reduktim gradual i këtij ndërsubvencionimi.
- 1.30 Ky ndërsubvencionim është një mekanizëm i trashëguar brenda kornizës tarifore i cili synon të mbrojë konsumatorët e varfër dhe të cenueshëm. Megjithatë, ky sistem vlen për të gjithë konsumatorët shtëpiak, pavarësisht nga të ardhurat e familjes. Rrjedhimisht, shumë konsumatorë marrin përfitimin e ndërsubvencionimit edhe pse nuk janë të varfër, të njohura si gabime të përfshirjes.
- 1.31 Propozimet tona për të përmirësuar koston reflektive përfshijnë reduktimin dhe heqjen eventuale të këtyre ndërsubvencioneve që do të rezultojë në një rritje marginale të faturave të ujit për konsumatorët shtëpiak. ARRU e pranon se kjo mund të sjellë vështirësi shtesë për disa familje. Mund të kërkohet një qasje më e shënjestruar për të ndihmuar familjet më të varfra me faturat e tyre.

### Ndryshimet e propozuara

- 1.32 ARRU do të shqyrtojë mekanizmat alternativë që synohen për të mbështetur konsumatorët më të varfër dhe më të cenueshëm ku zvogëlimi i heqjes së ndërsubvencionimit imponon vështirësi shtesë.

## 1.5 Mjedisi

### Qasja aktuale dhe arsyetimi ekonomik

- 1.33 Për industrinë e ujit dhe ujërave të ndotura ka dy çështje kryesore mjedisore; mbrojtja e burimeve ujore kundër mbi-ekstraktimit (nxjerrjes së tepruar të ujit nga burimet!) dhe mbrojtja e rrjedhave ujore nga ndotja me ujëra të ndotura.
- 1.34 ARRU ka inkurajuar KRU-të që të ndërmarrin aktivitetet e tyre duke i kushtuar rëndësi të lartë mbrojtjes së mjedisit dhe kemi lejuar mjete shtesë të kërkesat për të ardhura që të përmbushen obligimet e tilla, veçanërisht ndërtimin e objekteve të reja për trajtimin e ujërave të ndotura.
- 1.35 Megjithatë, ARRU mbetet e shqetësuar se burimet ujore mund të vuajnë nga mbi-ekstraktimi (nxjerrja e tepruar e ujit nga burimet!) që i atribuohet dështimit të vazhdueshëm të KRU-ve për të trajtuar humbjet në rrjetet e tyre. ARRU nuk është e bindur se KRU-të po bëjnë mjaftueshëm për të adresuar problemet e tyre të humbjeve të ujit. ARRU është e shqetësuar se KRU-të ende nuk kanë ndërmarrë hapat e parë në identifikimin e shkallës së problemit, niveleve ekonomike të rrjedhjeve dhe masave të nevojshme për të ofruar efikasitet më të madh operacional dhe mbrojtje nga mbi-ekstraktimi (nxjerrja e tepruar e ujit nga burimet) i burimeve ujore.
- 1.36 ARRU është e përkushtuar ndaj konceptit 'ndotësi paguan'. Në këtë drejtim, ARRU beson se tarifat e bazuara në cilësinë dhe vëllimin e ujërave të ndotura janë të nevojshme. Kjo është në harmoni me propozimet për përmirësimin e koston reflektive.

### Ndryshimet e propozuara

ARRU nuk merr në konsideratë vendosjen e objektivave arbitrare për reduktimin e humbjeve të ujit, por në vend të kësaj do të sigurohet që KRU-të të menaxhojnë humbjet e tyre në nivelin më ekonomik. Kjo bie jashtë fushëveprimit të këtij procesi tarifor dhe është më së miri që të rezervohet për dialog të drejtpërdrejtë ndërmjet ARRU dhe KRU-ve.

Propozimi i mësipërm për të përmirësuar koston reflektive me vendosje të tarifave të ujërave të ndotura sipas vëllimit dhe cilësisë së shkarkimit të ujërave të ndotura do ta përmbushë më mirë kriterin 'ndotësi paguan'.

## 1.6 Pyetjet për konsultim

1. A jeni të pajtimit me parimet e përgjithshme që ARRU ka identifikuar si objekt shqyrtimi? Nëse jo, ju lutemi jepni arsyet tuaja.
2. A keni ndonjë parim tjetër të përgjithshëm për t'i shtuar këtij rishikimi?

## 2 Mbulimi kostos – stimujt për përmirësimin e efikasitetit operacional

### 2.1 Çështja

- 2.1 Që nga viti 2009, kur ARRU paraqiti për herë të parë procesin e përcaktimit të tarifave tre-vjeçare, shumica e objektivave për përmirësimin e efikasitetit të paraqitura në planet e biznesit nuk janë arritur në vazhdimësi nga pothuajse të gjitha KRU-të.
- 2.2 Aktualisht, kompetencat e ARRU-së për të zbatuar përputhshmërinë me pritshmëritë e efikasitetit janë të kufizuara në vendosjen e sanksioneve relativisht të dobëta kur performanca nuk i përmbush pritshmëritë, veçanërisht për publikimin e të dhënave të performancës në raportet vjetore. ARRU e ka opsionin përfundimtar për t'i bërë rekomandime Qeverisë që t'i merr parasysht veprimet kundër bordeve të drejtorëve të KRU-ve, por kjo nuk është aplikuar asnjëherë.
- 2.3 Përveç qortimit të performancës së dobët, ARRU po hulumton opsione për stimujt të performancës së mirë. ARRU ka identifikuar dy opsione.

### 2.2 Opsioni 1 - përdorimi i performancës së lartë financiare për të financuar shpërblimet për menaxhmentin dhe stafin

#### Propozimi

- 2.4 Nëse KRU-të i tejkalojnë objektivat financiare të përcaktuara në planet e tyre të biznesit, të ardhurat shtesë mund t'i shpërndahen menaxhmentit dhe stafit si bonus. Shpërndarja e bonuseve duhet të jetë e kushtëzuar nga ajo se sa mirë KRU-të i përmbushin nivelet e obligimeve të performancës së shërbimit, d.m.th. performanca financiare që tejkalon objektivat nuk duhet të ketë si kundërvlerë rënie e nivelit të shërbimit. Që kjo të funksionojë ARRU duhet të miratojë dhënien e bonuseve të tilla dhe një miratim i tillë duhet të jepet vetëm nëse KRU-të mund të demonstrojnë se nivelet e shërbimit nuk janë ndikuar negativisht. Aty ku performanca e lartë financiare shoqërohet me rënie të niveleve të shërbimit, atëherë sistemi duhet të parashikojë që disa ose të gjitha të ardhurat shtesë t'u kthehen konsumatorëve në rishikimet pasuese të tarifave.
- 2.5 Që ARRU të sigurohet se performanca e lartë nuk vjen me koston e përkeqësimit të niveleve të shërbimit, duhet të përdoren burime për auditim dhe verifikim përtej kapaciteteve tona aktuale. ARRU do të të angazhojë firma të jashtme konsulente inxhinierike të kualifikuara për ta ndërmarrë këtë në emrin e saj. Kjo është e mundur përmes një mekanizmi si korniza 'raportuese' e aplikuar nga OFWAT në Mbretërinë e Bashkuar, ku 'raportuesit' emërohen nga kompanitë e ujit, por i raportojnë rregullatorit. Kjo është sikur emërimi i një auditori financiar që u raporton aksionarëve.

#### Vlerësimi i ndikimit

- 2.6 Nëse përfitimet e performancës financiare do të shpërndaheshin si bonuse, ndikimi afatshkurtër mbi tarifat është neutral. Në terma afatgjatë, ndikimi mund të sjellë tarifa që janë pothuajse fare më pak se sa do të ishin përndryshe për shkak të rivendosjes periodike të kostove bazë në çdo rishikim tarifar.
- 2.7 Ndikimi në tarifat e ardhshme është i vështirë për t'u vlerësuar pasi që potenciali për performancë të lartë është subjektiv. Sidoqoftë, ARRU beson se që një bonus të jetë mjaftueshëm domethënës për të nxitur ndryshimin, ai duhet të jetë kuptimplotë për marrësit, p.sh. në shtrirje prej 5% deri në 10% më shumë të shpërblimit. Mbi bazën e asaj që pagat dhe kostot e tjera të personelit përbëjnë rreth 1/3 e kërkesës për të ardhura, vlera financiare e performancës së lartë kundrejt objektivave do të duhej të ishte të paktën 3% e të ardhurave nga tarifat. Në rishikimet e ardhshme të tarifave, kjo performancë e lartë do të rezultonte në tarifa që do të ishin rreth 3% më pak se sa do të ishin përndryshe.

#### Këndvështrimi i ARRU-së

- 2.8 Megjithatë shpërndarja e fitimeve nga performanca e lartë financiare si bonuse është e shëndoshë në parim, ajo paraqet vështirësi për t'u zbatuar në praktikë:

- ARRU nuk është e bindur që KRU-të janë në gjendje të përmbushin objektivat aktuale të performancës dhe mund të jetë e dyshimtë se mund të arrihet një performancë e lartë në një nivel domethënës.
- Në të kaluarën, performanca e mbledhjes së të ardhurave ofronte mundësinë më të mirë për performancë të lartë që do të siguronte përfitime financiare materiale. Kjo është një fushë në të cilën KRU-të pothuajse i kanë përmbushur objektivat e tyre të performancës (në këtë kohë me rreth 96% të faturimeve arkëtohet). ARRU dyshon se kostot shtesë për të realizuar ndonjë përmirësim të mëtejshëm në këtë fushë do të rezultojnë me një fitim financiar të përgjithshëm neto minimal.
- Edhe pse ARRU sheh meritat e miratimit të një sistemi raportimi për monitorimin e performancës në përgjithësi, një sistem i tillë i përdorur vetëm për qëllime të validimit të bonuseve të performancës mund të mos jetë financiarisht i zbatueshëm.
- KRU-të, si ndërmarrje shtetërore, mund të mos sigurojnë mbështetjen e qeverisë për të lejuar dhënien e bonuseve. ARRU kërkon mendimin e qeverisë në këtë drejtim.

2.9 Nëse mund të jemi të sigurt se ky propozim ka të ngjarë të sjellë efikasitet të përmirësuar, tani dhe në të ardhmen, ARRU është e hapur për zbatimin e tij. ARRU mirëpret opinionet për këtë propozim.

## 2.3 Opsioni 2 -ofrimi i bonusit në planet e biznesit

### Propozimi

2.10 Ky është si propozimi i mësipërm, por në vend që të mbështetet në performancën e lartë financiare për të financuar bonuset, kërkesa për të ardhura në rishikimin e tarifave mund të përfshijnë një shtesë (grup të bonuseve) për bonuset që do t'i paguhen menaxhmentit dhe stafit në varësi të përmbushjes ose tejkalimit të nivelit të pritshmërive të performancës së shërbimit. Kjo duhet të rezervohet për ato fusha ku përmirësimi i performancës është më i rëndësishmi për konsumatorët, p.sh. ndërprerjet në furnizim, tejmbushjet e kanalizimeve, efikasiteti i kostos etj. Kjo marrëveshje do të ketë nevojë gjithashtu edhe për procese të fuqishme auditimi dhe verifikimi, por vetëm në fusha specifike të përmirësimit të performancës që i nënshtrohen pritshmërive për përmirësim. Nëse KRU-të dështojnë të përmbushin pritjet e performancës, elementi i papërdorur i bonusit do t'u kthehet konsumatorëve në rishikimin pasues të tarifave.

### Vlerësimi i ndikimit

2.11 ARRU konsideron se ky propozim mund të ketë një gjasë më të madhe për të ofruar përmirësime të performancës sesa mbështetja në performancën e lartë financiare për të financuar bonuset pasi që financimi sigurohet përmes tarifave. Ky propozim nuk është pa të meta, duke përfshirë:

- Ndikimi i tarifës do të jetë i menjëhershëm pasi që bonusi do të përfshihet në kërkesën për të ardhura. Konsumatorët mund të mos e pëlqejnë rritjen e tarifave si një bonus paraprak mbi bazën e pritshmërive për përmirësime që ende duhet të realizohen.
- Nëse KRU-të dështojnë të përmbushin objektivat e tyre të performancës, atëherë tërheqja e bonuseve do të reflektohet si reduktim i të ardhurave të kërkuara nga rishikimi pasues i tarifave, tre vjet më përpara. Ekziston rreziku që një reduktim i tillë i të ardhurave të kërkuara në të ardhmen të plotësohet nga një reduktim i shpenzimeve në fusha të tjera si investimet kapitale.
- Kjo ende do të kërkojë auditim dhe verifikim të fuqishëm për të siguruar që çdo sukses i raportuar i performancës është i vërtetë.

### Këndvështrimi i ARRU-së

2.12 ARRU nuk është e bindur që bonuset e financuara paraprakisht në një grup bonusesh do të konsiderohen të pranueshme nga konsumatorët dhe palët e tjera të interesuara. Edhe ARRU, gjithashtu, nuk është e kënaqur me këtë qasje dhe konsiderojmë se bonuset duhet të financohen nga efikasiteti i përmirësuar pa ndikuar negativisht në cilësinë e shërbimeve të kërkuara nga obligimet statutorë dhe të licencave të KRU-ve. ARRU mirëpret opinionet se si të ofrohen stimuj për KRU-të që të përmirësojnë performancën.

## 2.4 Pyetjet për konsultim

3. A jeni të pajtimit që ARRU duhet të përfshijë stimuj për përmirësimin e performancës në procesin e rishikimit të tarifave? Nëse jo, ju lutemi jepni arsyet tuaja.
4. A jeni dakord me qëndrimin tonë se bonuset duhet të financohen vetëm nga performanca e lartë financiare apo besoni se një qasje në lidhje me një grup paraprak të bonuseve mund të jetë më efektive ?
5. Nëse qasja e grupit të bonuseve është opsioni i preferuar, a duhet të kthehen paratë e dhëna si bonuse në rishikimet e ardhshme të tarifave nëse nuk arrihen përmirësimet e pritura në performancë?
6. A keni ndonjë sugjerim tjetër për përmirësimin e performancës operacionale, qoftë si stimuj apo sanksione?



### 3 Mbulimi i kostos – nxitja aktuale për shtyrjen e përmirësimeve të efikasitetit

#### 3.1 Çështja

- 3.1 Korniza aktuale u mundëson KRU-ve të gëzojnë përfitimet e efikasitetit për periudhën e rishikimit të tarifave. Nëse një KRU identifikon dhe zbaton një rritje të efikasitetit në vitin e parë të rishikimit, KRU-ja mund të gëzojë përfitimet për tre vitet e plota. Megjithatë, nëse përfitimi identifikohet në fund të vitit të dytë, fitimet gëzohen vetëm për një vit. Kjo mund të krijojë sjelljen e paqëllimshme që KRU-të të shtyjnë zbatimin e rritjes së efikasitetit deri në fillim të periudhës së ardhshme të rishikimit.
- 3.2 Kjo ilustron në Figura 3ku shtyrja e përfitimeve të efikasitetit rezulton në tarifa më të larta në periudhën pasuese të procesit tarifar se sa që do të ishin ndryshe.




Figura 3– Korniza aktuale e ndikimit të efikasitetit të përmirësuar në tarifa.

#### 3.2 Opsioni - kalimi i përfitimeve të efikasitetit gjatë një cikli rregullator në ciklin tjetër.

##### Propozimi

- 3.3 ARRU propozon të ndryshohet modeli për të mundësuar që përfitimet e efikasitetit të gëzohen për të paktën tre vjet, pavarësisht nga koha kur janë identifikuar dhe zbatuar për herë të parë. Kjo do të eliminonte nxitjen e KRU-ve që të shtyjnë çfarëdo nisme për përmirësimin e efikasitetit.
- 3.4 Kjo është ilustruar në Figura 4.




Figura 4– Korniza e propozuar që mundëson kalimin e përfitimeve të efikasitetit në periudhat pasuese të kontrollit të çmimeve

#### Vlerësimi i ndikimit

- 3.5 ARRU e konsideron ndikimin tarifor të këtij ndryshimi si pozitiv, pasi që ai do të avancojë kohën e nismave për përmirësimin e efikasitetit. Për shembull, nëse një KRU identifikoi një përfitim të efikasitetit që zvogëloi të ardhurat e kërkuara në fund të vitit të dytë të periudhës së parë të rishikimit dhe që u shty deri në fillimin e vitit të parë të periudhës së dytë rishikimit, konsumatorët do ta kuptonin përfitimin e përmirësimit jo më herët se në vitin e parë të periudhës së tretë të rishikimit, pra katër vjet pasi që ai ishte identifikuar. Duke eliminuar nxitjen për të shtyrë përmirësimin e efikasitetit, konsumatorët do të realizojnë përfitimin në vitin e tretë të periudhës së dytë të rishikimit, një vit më herët se sa që e lejon sistemi aktual.
- 3.6 Megjithatë, ka disa kufizime praktike në atë që informacioni i hollësishëm në lidhje me përmirësimet e efikasitetit në vitin e fundit të një periudhe rishikimi nuk do të jetë i disponueshëm gjatë vlerësimit të planeve të biznesit për rishikimin pasues. ARRU nuk e konsideron këtë si një pengesë të madhe dhe ka metoda të provuara dhe të testuara që janë përdorur nga rregullatorë të tjerë për ta kapërcyer këtë.

#### Këndvështrimi i ARRU-së

- 3.7 ARRU konsideron se lëvizja e cila mundëson që përfitimet e përmirësimeve të efikasitetit në një cikël rregullator, të kalojnë në ciklin tjetër, është një përfitim neto dhe duhet të miratohet.

### **3.3 Pyetje**

7. A pajtoheni me propozimin që të lejohet që përfitimet nga përmirësimet e efikasitetit të realizohen për tre vjet, pavarësisht nga koha se kur ato janë identifikuar dhe zbatuar? Nëse jo, jepni arsye tuaja.

## 4 Mbulimi i kostos – investimi kapital

### 4.1 Çështja

- 4.1 Gjatë pesë proceseve trevjeçare që nga viti 2009, planet e biznesit të KRU-ve kanë përfshirë një element domethënës të investimeve kapitale për mirëmbajtjen e kapitalit dhe rritjen e shërbimit, shih Tabela 1më poshtë.

Tabela 1– Si reflektohet investimi kapital në kërkesën për të ardhura<sup>2</sup>

Lloji i investimit	Përkufizimi	Si reflektohet në kërkesën për të ardhura
Përtërtitja e infrastrukturës (rrjetit).	Riparim ose zëvendësim i madh i aseteve të rrjetit të infrastrukturës për të mirëmbajtur nivelet e shërbimit bazë.	Kalimi i drejtpërdrejtë në kërkesën për të ardhura.
Rritja e infrastrukturës (rrjetit).	Zgjerimi i aseteve të rrjetit dhe investimi në përmirësimin e performancës së rrjetit.	Investimi i shtuar në bazën rregullatore të aseteve dhe që i nënshtrohet një kthimi në kapital në mënyrë të përhershme, i cili përfshihet në kërkesën për të ardhura
Mirëmbajtja kapitale e aseteve jo-infrastrukturore (asetet që nuk i përkasin rrjeteve si stacionet e pompimit dhe punimet e trajtimit)	Riparimi ose zëvendësimi madhor i aseteve jo-infrastrukturore për të ruajtur nivelet e shërbimit bazë.	I shtohet bazës rregullatore të aseteve dhe i nënshtrohet zhvlerësimit dhe kthimit në kapital që përfshihen në kërkesën për të ardhura.
Rritja e aseteve jo-infrastrukturore	Zgjerimi i aseteve jo-infrastrukturore dhe investimi në përmirësimin e performancës së rrjetit.	I është shtuar bazës rregullatore të aseteve dhe i nënshtrohet zhvlerësimit dhe kthimit në kapital që përfshihen në kërkesën për të ardhura.

- 4.2 ARRU rrallëherë e ka sfiduar nevojën për këtë investim meqenëse besojmë se ka qenë e nevojshme të mirëmbahet dhe përmirësohet niveli i shërbimit dhe kemi lejuar që kostoja e këtij investimi të reflektohet në tarifa.
- 4.3 Në fund të çdo procesi rregullator, ARRU ka konstatuar se një pjesë e madhe e këtij investimi nuk është materializuar kurrë. Paratë e parashikuara në tarifën për investime kapitale as nuk u kursyen dhe as nuk u morën si fitim shtesë, por u përdorën për të kompensuar dështimin për të përmbushur përmirësimet e pritshme të efikasitetit. Ata e konsiderojnë përfshirjen e një investimi të tillë në planet e tyre duke e ditur se këto angazhime nuk do të përmbushen si një mjet legjitim për rritjen e tarifave dhe shmangien e detyrimeve të tyre për të përmirësuar efikasitetin. ARRU ka bërë përpjekje që të inkurajojmë KRU-të që të heqin dorë nga kjo praktikë, por lutjet tona janë injoruar në masë të madhe.
- 4.4 Konsumatorët e kanë paguar çmimin e këtij dështimi duke financuar investime të cilat nuk u materializuan asnjëherë, duke rezultuar në rënien e niveleve të shërbimit dhe duke mos shijuar frytet e përmirësimeve të eficiencës që mund të ishin realizuar gjatë 15 viteve të fundit.
- 4.5 Konsumatorët duhet, në mënyrë goxha legjitime, të presin që t'i marrin paratë e tyre prapa ose të paktën të sigurohen se paratë të cilat i paguajnë për investim përdoren për atë qëllim dhe jo për të financuar jo efikasitetin. ARRU ka identifikuar dy zgjidhje të mundshme si më poshtë.

### 4.2 Opsioni 1 – Krijimi i një llogarie bankare specifike të rezervuar për investime e cila mund të përdoret vetëm për atë qëllim

#### Propozimi

- 4.6 Tani ARRU beson se duhet të ndërmerr veprime me shumë vendosmëri që të ndalim këtë spirale të vazhdueshme rënëse të përdorimit të angazhimeve për investime për të kompensuar dështimin për të realizuar përmirësimet e pritshme të efikasitetit.

<sup>2</sup> Investimi i financuar nga grantet nuk përfshihet në kërkesën për të ardhura pasi që, në përputhje me praktikën rregullatore konvencionale, investitorët nuk duhet të gëzojnë një kthim mbi aktivet të cilat ata nuk i kanë financuar.

- 4.7 Një zgjidhje e mundshme për këtë është ndarja e mjeteve për investime kapitale në një llogari të veçantë në të cilën KRU-të mund të kenë qasje vetëm për atë qëllim. Kjo do të thotë se pjesa e të ardhurave nga tarifat që ka të bëjë me investimet (përtëritja e infrastrukturës dhe zhvlerësimi i kostos aktuale) është rezervuar në një llogari të sigurt. Kjo mund të përfshijë gjithashtu komponentin e kthimit në kapital të kërkesës për të ardhura. Këto para mund të nxirren nga llogaria vetëm për qëllime të investimeve kapitale dhe shlyerjes së kredive kryesore (dhe interesit nëse përfshihet kthimi i kapitalit).

#### Vlerësimi i ndikimit

- 4.8 Megjithëse e thjeshtë në parim, analiza më e afërt zbulon disa probleme me qasjen e tij.
- Çështja e kthimit në kapital është një çështje debati. A duhet që llogaria e sigurt të përfshijë mjetet (rezervat) e kthimit në kapital? ARRU konsideron se qasja që me kthimin në kapital të paguhet interesi i kredive, dividendat ose ri-investimin nuk duhet të kufizohet në mënyrë të padrejtë. Megjithatë, përjashtimi i kthimit në kapital nga këto kufizime do të thotë se ky mekanizëm nuk do të ketë ndikim në zotimet e shpenzimeve për përmirësimin e infrastrukturës dhe do të ketë vetëm ndikim të kufizuar në përmirësimin jo-infrastrukturor.
  - Përfshirja e kthimit në kapital në këtë aranzhim do të nënkuptonte dhënien e një shkalle lirie veprimi KRU-ve lidhur me mënyrën se si përdoret kthimi në kapital (fitimi pas interesit). Nëse kjo kufizohet vetëm në ri-investim, atëherë ky sistem do të funksiononte, por nëse përdoret për financimin e bonuseve aty ku është e përshtatshme, apo, edhe madje të merret si dividenda, sistemi bëhet më i errët dhe më i vështirë për t'u kontrolluar.
  - Investimet në asetet jo-infrastrukurore janë përgjithësisht sporadike dhe, në afat të shkurtër, mund të tejkalojnë mjetet (rezervat) vjetore të zhvlerësimit, p.sh. një impiant i ri për trajtimin e ujit për të zëvendësuar një impiant të vjetërsuar. Mjetet në llogarinë e sigurt nuk do të jenë të mjaftueshme për të financuar investimin pa kredi. Do të jetë e vështirë që KRU-të t'i mbajnë zotimet e tyre të shpenzimeve nëse kjo tejkalon atë që është në llogarinë e sigurt.
  - Administrimi i një sistemi të tillë do të jetë sfidues. KRU-të tashmë kanë demonstruar se me dështimin e tyre të vazhdueshëm për të përmbushur zotimet e tyre për investime, vetë-rregullimi i një llogarie të tillë nuk ka gjasa të ketë sukses. Ka të ngjarë që ata të tundojnë që t'i qasen llogarisë për të financuar jo efikasitetin operacional. ARRU gjithashtu nuk beson se administrimi i një llogarie të tillë duhet të jetë përgjegjësi e jona si rregullator dhe sigurisht nuk besojmë se qeveria do të ishte e gatshme ta merrte përsipër këtë rol.

#### Këndvështrimi i ARRU-së

- 4.9 Koncepti i ndarjes së një pjese të të ardhurave nga tarifat për qëllime investimi mund të jetë i vështirë apo edhe i pamundur, ARRU nuk e ka shpërfillur këtë në tërësi. ARRU mirëpret opinionet për këtë propozim dhe sugjerimet se si të tejkalohen problemet që janë identifikuar.

### **4.3 Opsioni 2 – 'tërheqja e mjeteve' prej fondeve të ofruara përmes tarifave për mjetet e pashpenzuara të investimeve**

#### Propozimi

- 4.10 Përgjigja rregullatore konvencionale siç është zhvilluar nga Ofwat, rregullatori i sektorit të ujit në Mbretërinë e Bashkuar, është se në fund të çdo cikli rregullator ka një harmonizim (barazim) të investimit të planifikuar kundrejt investimit aktual dhe çdo diferencë neto bartet në periudhën e ardhshme të rishikimit. Ky harmonizim përfshin të gjithë elementët e kërkesës për të ardhura që lidhen me investimet e planifikuara dhe aktuale (përtëritja e infrastrukturës, zhvlerësimi i kostos aktuale dhe kthimi në kapital) dhe përshtatjen ndaj inflacionit në procesin tarifor pasues.
- 4.11 Nëse KRU-të investojnë më pak se plani i paraparë, atëherë barazimi do të rezultojë në një reduktim të kërkesës së të hyrave në periudhën e ardhshme të procesit tarifor. Të kundërtën nga kjo, nëse investimi aktual tejkalon atë që ishte planifikuar dhe konsiderohet nga ARRU si shpenzim i nevojshëm, atëherë kërkesa për të ardhura mund të përjetojë një rritje. Kjo në mënyrë efektive do t'i shpërblejë KRU-të për avancimin e investimeve me kusht që investimi të jetë i justifikuar. Për shembull, KRU-ja mund të identifikojë një investim, i cili nuk është përfshirë në planin e biznesit, si urgjent dhe thelbësor. ARRU

- do të lejonte që KRU të vazhdojë me investimin dhe kjo të përfshihet në procesin e barazimit. Kjo nuk do të mbulonte shpenzimet e panevojshme dhe jo urgjente të cilat nuk përfshihen në planin e biznesit.
- 4.12 ARRU pranon se një ndryshim i papritur në kornizën për tërheqjen e mjeteve të investimeve të pashpenzuara mund të rezultojë në zbritje të konsiderueshme të tarifave për KRU-të. ARRU gjithashtu pranon se konsumatorët nuk mund të shfrytëzohen për përfitime siç ka qenë rasti deri më tani. Propozimi ynë për tërheqje të mjeteve mund të zbatohet gradualisht duke u dhënë KRU-ve një mundësi të drejtë për të ndryshuar qasjen e tyre.
- 4.13 Andaj ARRU propozon opsionet e mëposhtme të zbatimit për procesin e tërheqjes së mjeteve për investimet e pa realizuara:
- A. Zbatimi i mekanizmit të tërheqjes mjeteve të aplikohet në planet e investimeve në periudhën aktuale të rishikimit tarifor 2022-2024 për t'u harmonizuar kundrejt investimit aktual që do të pasqyrohet në tarifat për periudhën e ardhshme të rishikimit 2025-2027.
- B. Zbatimi i mekanizmit të tërheqjes së mjeteve të aplikohet në planet e investimeve në periudhën e ardhshme të rishikimit tarifor 2025-2027, i cili do të harmonizohet kundrejt investimit aktual për t'u pasqyruar në tarifat për periudhën e rishikimit 2028-2030.
- 4.14 Opsioni A është në mënyrë efektive një aplikim retrospektiv i mekanizmit dhe KRU-të mund tashmë të kenë 'humbur' përfitimet e nën-investimit përmes përmirësimeve të efijencës dhe humbjeve të mëparshme. Do ta jetë e vështirë të rikuperojnë humbjet pas ngjarjes. Prandaj, ARRU konsideron se dhënia e njoftimit paraprak për qasjen e ardhshme që do të t'u jep atyre kohë për t'u përshtatur me ndryshimin është më e drejtë për KRU-të, por do të shtyjë përfitimet për konsumatorët. ARRU mirëpret opinionet tuaja për këtë propozim të politikave.
- 4.15 Për më tepër, ARRU gjithashtu po konsideron një tërheqje të pjesshme (të themi 50%) në rishikimin e parë për të ndarë në mënyrë efektive kostot ndërmjet konsumatorëve dhe KRU-ve, dhe një kthim të plotë prej 100% më pastaj. Këndvështrimi i ynë i konsideruar është që një tërheqje e pjesshme e mjeteve duhet të konsiderohet nëse ARRU do të miratojë një zbatim afatshkurtër sipas opsionit A. Nëse zgjidhet opsioni B i mësipërm, ARRU nuk sheh arsye pse nuk mund të zbatonim një kthim të plotë në periudhën e shqyrtimit 2028-2030.
- Vlerësimi i ndikimit*
- 4.16 Zvogëlimi i tarifave si rezultat i procesit të kthimit do të imponojë stresse në KRU-të dhe presim rezistencë nga ky kuartal. ARRU nuk i konsideron si ankesa legjitime streset shtesë në KRU. ARRU ka përcaktuar objektiva të cilat beson se janë sfiduese, por gjithsesi të arritshme. ARRU do të vazhdojë ta bëjë këtë, por në të ardhmen do të sigurohet që nga konsumatorët të mos pritët të financojnë investime të cilat nuk realizohen.
- 4.17 Administrimi i këtij procesi kufizohet në procesin e përcaktimit të tarifave rregullatore dhe nuk kërkon ndonjë komponent shtesë rregullator ose mbikëqyrës. ARRU e konsideron këtë proces si më të thjeshtë dhe më të zbatueshëm se sa Opsioni 1.

#### 4.4 Pyetje

8. A pajtoheni që nevojiten veprime rregullatore për të siguruar realizimin e investimeve të planifikuara? Nëse jo, tregoni arsyet tuaja.
9. Cili është mendimi juaj në lidhje me Opsionin 1, prezantimi i një llogarie të veçantë vetëm për aktivitetet e investimit? A jeni dakord me vlerësimin tonë për kufizimet dhe praktikatat e kësaj qasjeje? Nëse jo, tregoni arsyet tuaja.
10. A keni ndonjë sugjerim për të tejkaluar disa ose të gjitha kufizimet për Opsionin 1 të cilin e kemi identifikuar?
11. Cili është mendimi juaj në lidhje me Opsionin 2, në lidhje me tërheqjen e mjeteve të cilat i gëzojnë KRU-të për investime të përcaktuara dhe të cilat u kthehen konsumatorëve në periudhën pasuese të rishikimit të tarifave? A jeni dakord me vlerësimin tonë për këtë proces si opsion të preferuar?
12. A pajtoheni me këndvështrimin tonë 'të prirur' që procesi i tërheqjes së mjeteve për investimet e pa realizuara duhet të nisë me një harmonizim të investimeve gjatë periudhës 2025-2027 për t'u reflektuar në tarifatat për periudhën 2028-2030? Nëse jo, tregoni arsyet tuaja.
13. A pajtoheni që nëse e zbatojmë sipas kalendarit të mësipërm, ARRU duhet të kërkojë një tërheqje të plotë të mjeteve për periudhën 2028-2030? Nëse jo, tregoni arsyet tuaja.
14. A jeni dakord se nëse e zbatojmë tri vite më herët, pra që harmonizimi i investimeve në periudhën 2022-2024 të reflektohet në tarifatat për 2025-2027, tërheqja e mjeteve duhet të zvogëlohet le të themi për 50%? Nëse jo, tregoni arsyet tuaja.
15. A keni ndonjë mendim apo sugjerim të mëtejshëm për të zgjidhur dilemën e KRU-ve, që përfshijnë investimet vazhdimisht në planet e tyre të biznesit, mbi të cilat përcaktohen tarifatat, por më pas mos investimi i premtuar nuk realizohet?

## 5 Mbulimi i kostos - aplikacionet e planeve të biznesit me cilësi të dobët

### 5.1 Çështja

- 5.1 Cilësia e aplikacioneve të planeve të biznesit çdo tre vjet është ende nën pritshmëritë e ARRU-s. ARRU nuk beson se kjo i atribuohet mungesës së të kuptuarit të planit të biznesit dhe modeleve të përcaktimit të tarifave nga ana e KRU-së pasi që ato kanë përdorur modelet e njëjta për shumë vite. ARRU konsideron se dështimi duket të jetë se KRU-të nuk i marrin mjaft seriozisht përgjegjësitë e tyre rregullatore. ARRU konsideron se ato i parashtrajnë planet e tyre me synimin për të maksimizuar të ardhurat përmes përfshirjes së aktiviteteve (investime në pjesën kryesore) pa asnjë qëllim real për t'i përmbushur ato. ARRU ka propozuar zgjidhje për dilemën e investimeve kapitale në propozimet e mëparshme përmes tërheqjes së mjeteve nga investimi i pa realizuar, por ARRU beson se mund ta përmirësojë situatën më tej duke prezantuar një stimul financiar për KRU-të që të ofrojnë plane biznesi me cilësi të lartë që mbështeten nga dëshmi të forta duke na dhënë besimin se ato janë të menduara mirë, të dizajnuara siç duhet dhe se reflektojnë performancën aktuale.

### 5.2 Opsioni – ofrimi i një stimulimi financiar për të ofruar plane biznesi me cilësi të lartë.

#### Propozimi

- 5.2 Korniza rregullatore e Mbretërisë së Bashkuar si për ujin ashtu edhe për dhe energjinë ka kërkuar plane biznesi me cilësi të lartë. Kjo u arrit nga ato që quhen plane 'fast-track (i shpejtë!)' dhe 'slow-track (i ngadalte)'. Ku një plan i dorëzuar konsiderohet nga rregullatori të jetë i një cilësie të lartë për sa i përket: dizajnit, kompletimit dhe shërbimit të mirë të konsumatorëve përmes parashikimeve realiste, por sfiduese të përmirësimeve dhe kostove të eficientës, atij i jepet statusi 'fast-track'. Planet të tilla nuk do t'i nënshtrohen të shkallës së njëjtë të rishikimit si planet e mbetura 'të ngadalta'. Për të ofruar një stimul për t'u kualifikuar si 'fast-track', rregullatori aplikon një kthim pak më të lartë të kapitalit në planet e tyre, duke siguruar kështu një shpërblim financiar për parashtrimin e tarifave me cilësi të lartë. Një proces i tillë mund të konsiderohet në Kosovë për ofrimin e stimujve që planet e parashtruara të jenë të një cilësie shumë më të lartë se sa kanë qenë deri më sot. Stimujt financiar do t'i inkurajonin KRU-të që ta marrin planifikimin e tyre të biznesit më seriozisht sesa që e bëjnë. Gjithashtu kjo mund t'i inkurajojë KRU-të që t'a përdorin ekspertizën e jashtme të kualifikuar për t'i ndihmuar në zhvillimin e planeve të tyre të biznesit të cilat ne do t'i mbështesim.

#### Vlerësimi i ndikimit

- 5.3 Për të ilustruar shkallën e stimullit, BRR/Baza Rregullatore e Aseteve e KRU-së së Prishtinës është afërsisht 77 milionë euro. Nëse, përmes kualifikimit si 'fast-track', kthimi në BRR do të rritej me 0.25%, të ardhurat shtesë në vit për KRU-në e Prishtinës do të ishin 192,500 EUR në vit ose 577,500 EUR në periudhën tre vjeçare. Megjithatë kjo mund të sugjerojë që tarifatat do të ishin më të larta, kundër-argumenti është se një plan biznesi i zhvilluar mirë me objektiva më ambicioze për përmirësimin e efikasitetit operacional dhe komercial mund të rezultojë në një efekt neto të tarifave që janë më të ulëta se sa do të ishin për një parashtrim me cilësi më të dobët 'të ngadalte'.

#### Këndvështrimi i ARRU-së

- 5.4 ARRU konsideron se ndikimi financiar i zbatimit të një skeme nxitëse për të inkurajuar parashtrimet e përmirësuar të planeve të biznesit vështirë se do të ndihet nga konsumatorët. ARRU konsideron se përfitimet e planeve të përmirësuar të biznesit do t'u sjellin përfitime KRU-ve dhe konsumatorëve njëjloj.
- 5.5 Nëse ky proces shkon drejt zbatimit, ARRU do të duhet të përcaktojë udhëzime të qarta për atë që presim nga një plan biznesi 'fast-track (i shpejtë)', përfshirë nivelin e hollësive të nevojshme për ARRU që të vlerësojë siç duhet planin, arsyetimin e shpenzimeve, parashikimet realiste për përmirësimet të eficientës, dëshmitë që mbështesin zotimet e investimeve, përfshirë marrëveshjet e kredive etj.

### 5.3 Pyetje

16. A pajtoheni që ofrimi i një stimulimi për KRU-të që të ofrojnë plane biznesi me cilësi të lartë do të sjell përfitime neto për KRU-të dhe konsumatorët njëjloj? Nëse jo, tregoni arsyet tuaja.
17. A duhet të jetë stimulimi në formën e një rritjeje në masë të vogël të kthimit në kapital apo nëpërmjet një mekanizmi tjetër?
18. A keni ndonjë sugjerim tjetër që do të përmirësojë cilësinë e planeve të parashtruara të biznesit?



## 6 Kosto reflektive – heqja graduale e ndërsbvencionimit aktual

### 6.1 Çështja

- 6.1 Struktura aktuale tarifore përfshin një marrëveshje të trashëguar ku tarifat për njësi për konsumatorët shtëpiak janë dukshëm më të ulëta se ato të konsumatorëve jo shtëpiak. Mbulimi i kostos plotësohet duke qenë se tarifat mesatare të ponderuara janë të barabarta me ato që do të ishin nëse tarifat do të ishin të pa subvencionuara.
- 6.2 Që nga viti 2012, ka qenë politikë tarifore heqja graduale e ndërsbvencionimit që është ndjekur në procese tarifore, por shumë ngadalë. Tarifat jo-shtëpiake për ujë dhe ujëra të ndotura ishin afërsisht 2.5 herë më të larta se tarifat shtëpiake në vitin 2012, por sot, më shumë se 10 vjet më vonë, kjo diferencë ka rënë në 1.5 për ujin dhe 2.2 për ujërat e ndotura.
- 6.3 Disa konsumatorë jo shtëpiak kanë shprehur shqetësimin e tyre se ky diskriminim në çmim po ndikon negativisht në bizneset e tyre. Disa madje kanë sugjeruar që ata mund të marrin në konsideratë shkëputjen nga shërbimi i KRU-ve dhe burimin e tyre vetjak të ujit nga pusët.
- 6.4 Ky subvencionim është ekonomikisht joefikas. Ai ofron një subvencion për të gjithë konsumatorët shtëpiak pavarësisht nga të ardhurat e familjes, dhe është një kosto e pajustificuar për biznesin që mund të ndikojë në konkurrencën e tij dhe inkurajon konsumin e tepruar të ujit nga konsumatorët shtëpiak me një çmim nën kosto. ARRU nuk sheh asnjë justifikim financiar ose ekonomik për mbajtjen e këtij subvencioni që mund të kompensojë këto humbje (ndërmjet prodhimit dhe konsumit!) të rënda.
- 6.5 Ndërsbvencionimi për tarifat e ujërave të ndotura është përgjithësisht më i madh për ujërat e ndotura sesa për furnizimin me ujë. Kjo ishte bazuar në një supozim fillestar se ujërat e ndotura nga konsumatorët jo-shtëpiak ishin më ndotëse sesa ato nga konsumatorët shtëpiak. Tani besojmë se ky supozim mund të mos jetë aq i fortë sa mendohej fillimisht. Për shumicën e konsumatorëve jo-shtëpiak (dyqanet, qendrat tregtare, zyrat, institucionet arsimore dhe të tjera) nuk ka asnjë arsye për të besuar se ujërat e ndotura të tyre do të jenë më ndotëse sesa ujërat e ndotura shtëpiake. Prandaj ARRU konkludon se argumentet për heqjen e ndërsbvencionimit për ujë zbatohen njëjloj si për ujërat e ndotura dhe janë marrë në konsideratë në këtë propozim së bashku.
- 6.6 Sidoqoftë, ARRU e pranon se ka disa konsumatorë më të mëdhenj industrialë, ujërat e ndotura të cilëve janë në mënyrë materiale të ndryshme nga ujërat e ndotura shtëpiake. Kjo çështje adresohet në një propozim tjetër në këtë konsultim ku ne marrim parasysh kalkulimin e tarifave bazuar në cilësi për përdoruesit e përzgjedhur industrialë.

### 6.2 Opsioni 1 - heqja e ndërsbvencionimit përgjatë një procesi tarifor

#### Propozimi

- 6.7 ARRU propozon heqjen e ndër-sbvencionimit qoftë në mënyrë të menjëhershme apo me heqje të graduale përgjatë një periudhe të vetme të rishikimit tarifor prej tri vitesh.

#### Vlerësimi i ndikimit

- 6.8 Analiza jonë sugjeron se heqja e ndërsbvencionimit do të rrisë në mënyrë marginale tarifat për konsumatorët shtëpiak me rreth 6% mbi dhe më shumë se rritjet e tjera për shkak të inflacionit dhe efekteve të tjera. Tarifat për konsumatorët jo shtëpiak do të bien me rreth 29%. ARRU ka besim se, me kalimin e kohës, përfitimet ekonomike neto nga heqja e ndërsbvencionimit (rezultati i rritur ekonomik nga konsumatorët jo shtëpiak dhe kostot e reduktuara afatgjata të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe ujërave të ndotura) do të sigurojnë kompensim më të lartë se sa ndikimet afatshkurtra të heqjes së ndërsbvencionit.

- 6.9 ARRU ka marrë parasysh ndikimin në familjet e cenueshme. Analiza e fundit ofron informacione të hollësishme mbi varfërinë e familjeve në Kosovë që mund të udhëheqë këtë vendimmarrje<sup>3</sup> dhe<sup>4</sup>. Ky hulumtim na tregon se<sup>5</sup>:
- Të ardhurat mesatare të një familje urbane janë 7,165 euro në vit (6,230 euro në vit në vitin 2018 të përshtatura kundrejt inflacionit të pagave).
  - Niveli 20 përqindësh i të ardhurave të familjes është rreth 2,800 euro në vit (shih Figura 5).
  - Rreth 16% e familjeve urbane konsiderohen të varfra dhe 5% konsiderohen jashtëzakonisht të varfra.
  - Varfëria është dukshëm më e përhapur në familjet me shumë anëtarë (95% e të varfërve janë në familje që përfshijnë katër ose më shumë persona (90% e të gjitha familjeve).
- 6.10 Prandaj, ARRU ka arritur në përfundimin se çdo presion financiar në lidhje me faturat e ujit, sipas të gjitha gjasave, do të lidhet me familjet më të mëdha ku konsumi i ujit ka të ngjarë të jetë i lartë, por të ardhurat mund të jenë të ulëta.




Figura 5- Profili i të ardhurave urbane të vlerësuara për Kosovën (2017)

- 6.11 ARRU ka marrë parasysh konsumin e ujit bazuar në një nivel minimal për nevoja thelbësore. ARRU është bazuar në një studim të fundit i cili përcakton ‘konsumin bazë absolut’ (ABC)<sup>6</sup>si:

*‘Niveli i dytë i stilit të jetesës, i cili korrespondon me nivelin e dytë të Maslow, i cili përfshin sigurinë si dhe mirëqenien bazë fiziologjike, përkufizohet si konsumi bazë absolut (ABC). Në këtë studim ABC mund të konsiderohet si kërkesa minimale personale ditore për ujë në hapësira të brendshme për një mënyrë jetese të shëndetshme moderne urbane dhe u përcaktua kështu për të përfaqësuar një skenar të kufizimeve të ujit gjatë kushteve të një thatësire ose të jetesës në një klimë të pamjaftueshme uji. Përdorimi i ujit në hapësira të jashtme, duke përfshirë ujitjen e kopshtit, mirëmbajtjen e pishinave, larjen e makinave dhe pastrimin e pajisjeve sportive, nuk u konsiderua si domosdoshmëri kur merren parasysh kërkesat minimale të ujit për nivelin e stilit të jetesës ABC.’*

- 6.12 Ky hulumtim i raportit sugjeron se konsumi për kokë banori do të ishte në rendin e 175 litrave në ditë për një familje me një banor, duke rënë në rreth 75 litra për kokë banori në ditë për një familje me 7 persona<sup>7</sup>. Kjo barazohet me një shtrirje të konsumit familjar prej rreth 5m<sup>3</sup> deri në 16m<sup>3</sup> në muaj (shih Figura 6).

<sup>3</sup>Dr. Peter J. Middlebrook dhe të tjerët, Vlerësimi i ndikimit të krizës së Ukrainës në Kosovë, UNDP, dhjetor 2022

<sup>4</sup>Monica Robayo-Abril, Trinidad Saavedra Facusse, Carlos Silva-Jauregui (nga Banka Botërore dhe Besa Haqifi, Naime Rexhepi dhe Avniu Kastrati (nga Zyra Statistikore e Kosovës (ASK)). Varfëria e konsumit në Republikën e Kosovës, Banka Botërore dhe ASK, maj 2019.

<sup>5</sup>Këto supozime janë nxjerrë nga llogaritjet e interpolimit duke përdorur të dhënat e regjistruara në raporte.

<sup>6</sup>AQUA — Infrastruktura e ujit, Ekosistemet dhe Shoqëria Vëllimi 00 Nr 0, 1 doi : 10.2166/aqua.2021.056. Përcaktimi i konsumit të ujit të brendshëm bazuar në aktivitetet personale të përdorimit të ujit, 2021.

<sup>7</sup>Përdorimi i ujit për kokë banori = SPC x d<sup>-0.439</sup> ku SPC = konsumi i vendbanimit me një banor dhe d = numri i personave në familje.

- 6.13 Duke kombinuar ABC-në me tarifën mesatare të ponderuara, ARRU ka vlerësuar faturën e ujit dhe ujërave të ndotura të ABC (Konsumi Bazë Absolut)-së në varësi të madhësisë së familjes (shih Figura 7).




Figura 6– Konsumi Bazë Absolut (ABC) dhe madhësia e familjes




Figura 7– Fatura vjetore ABC dhe madhësia e familjes

- 6.14 Duke përdorur një tarifë mesatare të ponderuar (ujë plus ujërat e ndotura) prej 0,48 euro/m<sup>3</sup> plus tarifa fikse 1,00 euro në muaj plus TVSH-ja, faturat vjetore të ujit për ABC do të kapin vlerat nga rreth 50 euro për një familje me një anëtar në rreth 120 euro për një familje me shtatë persona.
- 6.15 Duke supozuar një tavan përballueshmërie prej 5% të të ardhurave familjare të cilat mund të shpenzohen për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura, analiza jonë sugjeron se pak më pak se 13% e familjeve ka të ngjarë të përjetojnë vështirësi në përmbushjen e faturave të ujit.
- 6.16 Analiza jonë gjithashtu shpalos se përballueshmëria kufizohet kryesisht në familjet më të mëdha prej katër apo më tepër personave.
- 6.17 Duke hequr ndërsuvencionimin dhe duke rritur tarifën me 7%, numri i familjeve që do të kenë probleme në pagesën e faturave do të rritet në masë të vogël prej 14.8% të të gjitha familjeve, një rritje prej 2.2% dhe do të kufizohet ende kryesisht në familjet prej katër apo më tepër personave.
- 6.18 Thellësia e kufizimeve të përballueshmërisë, megjithatë, nuk është aq e madhe. Analiza jonë sugjeron që për ato familje të cilat janë subjekt i kufizimeve të përballueshmërisë, diferenca mesatare midis

faturave dhe kufizimeve të tyre të përballueshmërisë është aktualisht më pak se 20.00 euro në vit (rreth 1.65 euro në muaj). Ndikimi i heqjes së ndërsbvencionimit e rrit këtë në pak më pak se 24.00 euro në vit (më pak se 2.00 euro në muaj). Rritja mesatare për një familje është 3.86 euro në vit ose 0.32 euro në muaj. Për familjet e mëdha me shtatë apo më tepër kjo rritje është 4,27 euro në vit, apo 0,36 euro në muaj.

- 6.19 Megjithëse rritja do të imponojë stresse shtesë për një numër të vogël familjesh, ARRU konsideron se ndikimi negativ është minimal.

Këndvështrimi i ARRU-së

- 6.20 ARRU konkludon se përfitimet nga heqja e ndërsbvencionimit janë kryesisht të përballueshme dhe duhet të zbatohen brenda dy cikleve të ardhshme tarifore.

### 6.3 Pyetje

19. A pajtoheni që ndërsbvencionimi ekzistues është një shtrembërim i çmimit që ka një ndikim neto negativ ekonomik? Nëse jo jepni arsyet tuaja.
20. A jeni dakord që ndërsbvencionimi ofron një përfitim financiar për shumicën e konsumatorëve të cilët nuk kanë nevojë për të?
21. A pajtoheni që ndikimi i heqjes së ndërsbvencionimit është aq i vogël sa të mos ketë ndonjë ndikim material në përballueshmërinë e konsumatorëve më të varfër? Nëse jo jepni arsyet tuaja.
22. A pajtoheni me qëndrimin tonë që ndërsbvencionimi për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura duhet të hiqet dhe nëse po, a jeni dakord që ai duhet të ndodh në mënyrë të menjëhershme apo me faza? Nëse jo jepni arsyet tuaja.
23. A keni ndonjë koment tjetër për të bërë në lidhje me propozimin tonë për heqjen e ndërsbvencionimeve?

## 7 Kosto reflektive - zëvendësimi i tarifave fikse mujore me një tarifë të bazuar në madhësinë e gypit të lidhjes

### 7.1 Çështja

7.1 Plani aktual tarifar parashikon një tarifë fikse prej 1.00 euro në muaj për konsumatorët shtëpiak dhe 2.00 euro për konsumatorët jo shtëpiak. Kjo është një marrëveshje e trashëguar dhe që lidhet me ndërsuvencionimin vëllimor për shërbimet e furnizimit me ujë dhe ujërave të ndotura. Nuk ka arsye financiare pse ekzistojnë dallime të tilla, posaçërisht për bizneset e vogla ku lidhja e tyre nuk është më e madhe se ajo e një lidhjeje uji shtëpiake. ARRU konsideron një lëvizje drejt tarifave fikse më reflektuese të kostos që do të heqin ndërsuvencionimin dhe do ta zëvendësojnë atë me një grup tarifash më reflektuese të kostos të bazuara në madhësinë e lidhjes.

### 7.2 Opsioni – të aplikohet tarifa fikse bazuar në madhësinë e gypit të lidhjes

#### Propozimi

7.2 Tarifa fikse duhet të mbulojë kostot që nuk lidhen me vëllimin e shërbimit duke përfshirë leximin e ujmëmatësit, përgatitjen e faturave dhe mbledhjen e të ardhurave. Mund të përfshihen edhe shërbime të tjera ndaj klientit. Një kosto kryesore është riparimi ose zëvendësimi periodik i ujmëmatësit, gjë e cila varet nga madhësia e gypit të lidhjes.

7.3 ARRU propozon heqjen e ndërsuvencionit për tarifat mujore fikse. Tarifat mujore fikse në të ardhmen do të bazohen në madhësinë e gypit të lidhjes për të pasqyruar kostot e ofrimit të shërbimit që nuk lidhen me vëllimin, në veçanti koston e zëvendësimit periodik të ujmëmatësit.

#### Vlerësimi i ndikimit

7.4 ARRU ka shqyrtuar kostot e furnizimit dhe instalimit të ujmëmatësit të cilat ndryshojnë nga afërsisht 50,00 euro për një matës të vogël shtëpiak me diametër 15 mm, deri në afro 1,500.00 euro për një ujmëmatësit më të madh me diametër 150 mm që përdoret nga një biznes të madh. Kostoja mujore e këtij zëvendësimi të njehsorit varion nga 1,00 euro për njehsorin shtëpiak 15 mm në mbi 25,00 euro për një njehsor me diametër 50 mm, që është dukshëm më shumë se 2,00 eurot të cilat tarifohen sot. Mund të argumentohet se konsumatorët shtëpiak dhe ata të vegjël jo shtëpiak po subvencionojnë konsumatorët më të mëdhenj jo shtëpiak.

7.5 Në vend që të kemi një tarifë të veçantë për çdo madhësi të njehsorit, ARRU propozon një gamë madhësish njehsorësh dhe tarifën fikse mujore përkatëse. Për të ofruar një tregues të ndikimit të tarifave më reflektuese të kostos, Tabela 2 është zhvilluar duke anuitizuar koston e zëvendësimit të njehsorëve gjatë 5 viteve. Kjo është vetëm indikative dhe mund të nevojitet një analizë më e detajuar për zbatimin.

Tabela 2– Tarifat fikse të sugjeruara të cilat reflektojnë koston bazuar në madhësinë e lidhjes

Gama e madhësisë së njehsorit	Tarifa fikse e sugjeruar e përafërt (EUR/muaj)
15-20 mm	1.00
25 – 50 mm	2.00
65 – 100 mm	8.00
125 – 200 mm	20.00
250 mm	50.00
Më i madh se 250 mm	Duhet të përcaktohet

7.6 Modeli aktual i përcaktimit të tarifave është i tillë që tarifat fikse zbriten nga kërkesa e të ardhurave dhe bilanci pasqyrohet në tarifat vëllimore. Vendosja e grafikut të lartpërmendur të tarifave nuk do të rezultojë në përfitime shtesë për KRU-të.

- 7.7 ARRU vlerëson se do të duhet të mbështetemi tek KRU-të që të zbatojnë tarifën dhe të na informojnë për të ardhurat e tyre të pritura nga këto tarifa. ARRU do të kërkojë që ato të inkorporohen në model si pjesë e aplikacioneve të tyre tarifore që dorëzohen tek ne. Kjo mund të jetë subjekt i një shkalle gabimi në aplikacionin e parë, por ne konsiderojmë se kjo do të jetë një efekt i përkohshëm derisa KRU-të të kenë përmirësuar informacionet për lidhjet e tyre. Sigurisht, që ARRU merr parasysht se KRU-të duhet të kenë të dhëna të mjaftueshme për konsumatorët e tyre më të mëdhenj dhe çdo gabim do të jetë minimal.
- 7.8 Disa konsumatorë mund të kenë një lidhje që është më e madhe se sa nevojat e tyre dhe mund të mendojnë se ata mund t'i nënshtrohen një tarife fikse që është më e lartë se sa nëse lidhja do të ishte e madhësisë së duhur. Në rrethana të tilla ARRU do t'i inkurajojë KRU-të që të zbatojnë diskrecionin në aplikimin e tarifave të tyre fikse dhe/ose të ofrojnë ndryshimin e lidhjes në një lidhje më të përshtatshme për nevojat e konsumatorit.

#### Këndvështrimi i ARRU-së

- 7.9 ARRU konsideron se ndërsubvencionimi i tarifave fikse duhet të hiqet dhe të zëvendësohet me një tarifë më reflektuese të kostos të bazuar në madhësinë e lidhjes dhe se kjo duhet të zbatohet në fillim të periudhës së ardhshme të rishikimit të tarifave.

### **7.3 Pyetje**

- 24. A pajtoheni që ndërsubvencionimi në tarifën fikse të hiqet? Nëse jo jepni arsyet tuaja.**
- 25. A pajtoheni që tarifën fikse të bazuar në madhësinë e lidhjes janë më të reflektuese të kostos dhe më të përshtatshme? Nëse jo jepni arsyet tuaja.**
- 26. A jeni të pajtimit që skema përmbledhëse e tarifave që kemi sugjeruar është e arsyeshme? Nëse jo jepni arsyet tuaja.**
- 27. A keni ndonjë sugjerim alternativ për ndryshimin e tarifave fikse?**

## 8 Kosto reflektive – tarifat për përforcimin e infrastrukturës në largësi

### 8.1 Çështja

8.1 'Dokumenti i Qeverisë për Politikën e Ujërave' aktual (2015), i përgatitur nga Këshilli Ndërmnistror i Ujit (KPM) deklaroi:

***Deklarata e Politikës: Tarifa e zhvillimit të infrastrukturës***

*Qeveria u bën thirrje komunave, në bashkëpunim me ZRRUM-të dhe KRU-të, që të shqyrtojnë aplikimin dhe mbledhjen e tarifës për zhvillimin e infrastrukturës ujore krahas tarifës për zhvillimin e infrastrukturës komunale (për rrugët, kanalizimin, ndriçimin rrugor etj.). Tarifa e zhvillimit të infrastrukturës ujore duhet të jetë një tarifë e rregulluar që i nënshtrohet miratimit të ZRRUM-it.*

8.2 Deri më sot, tarifat e zhvillimit të infrastrukturës për infrastrukturën e furnizimit me ujë dhe ujërat e ndotura nuk janë aplikuar, por për të përmbushur pritshmëritë e këtij objekti të politikës, ky dokument shqyrton opsionet për aplikimin e tij në të ardhmen.

8.3 Me zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit, shtohen konsumatorë të rinj. Kjo përfshin:

- Ndërtime të reja banesore të cilat rezultojnë në zgjerimin e rrjetit dhe rritjen e kërkesës.
- Ndërtime të reja tregtare dhe industriale të cilat gjithashtu rezultojnë në zgjerimin e rrjetit dhe rritjen e kërkesës.
- Ndërtime të reja (shtëpiake dhe jo shtëpiake) në zonat ekzistuese të zhvilluara, por që mund të mos kontribuojnë domosdoshmërisht në rritjen e kërkesës.
- Pronat ekzistuese të cilat nuk janë të lidhura me sistemin, por me zgjerimin e sistemit, ka mundësi që ato të lidhen (kjo vlen në radhë të parë për ujërat e ndotura dhe jo për furnizimin me ujë)
- Miratimi i zonave shpesh të shërbimit dhe sistemeve përcjellëse të furnizimit me ujë në pronësi të kompanive rajonale të ujit (KRU-ve).

8.4 Këto aktivitete kërkojnë investime në infrastrukturën terciare dhe gjithashtu mund të kenë një efekt negativ në zhvillimin më të gjerë të infrastrukturës, të cilat, në disa raste, mund të ofrojnë justifikim për të aplikuar taksa për ndërtuesit e banesave, bizneset dhe konsumatorët. Kjo infrastrukturë terciare zakonisht ndërtohet nga zhvilluesit dhe i dorëzohet KRU-ve pas përfundimit. KRU-ja do të aplikojë një taksë për kyçe për pronat individuale për të mbuluar kostot e gypave të shërbimit, njehsorëve dhe aparateve të tjera të nevojshme specifike për konsumatorët individualë plus një shumë për të përballuar kostot administrative përkatëse.

8.5 Në shumë raste, infrastruktura më e gjerë terciare që nuk lidhet me ujin (rrugët, ndriçimi i rrugëve dhe kanalizimi etj.) zhvillohet nga komuna dhe ngarkohet nëpërmjet një *tarife për zhvillimin e infrastrukturës komunale*. Kjo nuk përfshin domosdoshmërisht ofrimin e infrastrukturës së shërbimeve të furnizimit me ujë dhe ujërave të ndotura. Në disa raste, komunat mund të zhvillojnë infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimit ose të kërkojnë nga KRU-të që ta ofrojnë atë. Këto kosto më pastaj i kalohen zhvilluesit.

8.6 Në shembujt e mësipërm kostoja e infrastrukturës terciare u bartet në mënyrë efektive konsumatorëve të rinj. Kjo bëhet qoftë përmes përfshirjes në çmimin e blerjes apo qiradhënies së pronës plus çfarëdo tarife lidhjeje të ndërlidhur, kjo e fundit paguhet përmes zhvilluesit apo drejtpërdrejt ndërmjet konsumatorit të ri dhe KRU-së.

8.7 Megjithatë marrëveshjet aktuale parashohin që kostot e zhvillimit të infrastrukturës terciare të kalohen tek konsumatorët e rinj, këto zhvillime mund të rezultojnë në investime të nevojshme kapitale shpesh në infrastrukturën e sipërme (ujore) ose në rrjedhën e poshtme (ujërat e ndotura) si tubacione shpesh, rritje të kapacitetit të pompimit dhe të ruajtjes. Nuk ka dispozita që kostot e këtyre investimeve shpesh të barten tek konsumatorët e rinj të cilët i kanë imponuar ato. Kostot e këtyre investimeve shpesh për të gjithë konsumatorët me përfshirjen e tyre në planet e biznesit të KRU-ve dhe kalohen në tarifa. ARRU konsideron se konsumatorët ekzistues nuk duhet të pritet të financojnë këtë sforcim të rrjetit përmes tarifave nëse nevoja për këtë sforcim shkaktohet nga konsumatorët e rinj. Imponimi i kostove të tilla për konsumatorët ekzistues nuk konsiderohet si kosto reflektive dhe mund të konsiderohet si i

padrejtë. Përmirësimi i kostos reflektive mund të arrihet nëpërmjet shpërndarjes së këtyre kostove të investimeve shtesë tek konsumatorët e rinj të cilët e nxitën investimin.

8.8 Industria e ujit në Mbretërinë e Bashkuar e ka trajtuar këtë çështje përmes vendosjes së asaj që ata i referohen si një *'tarifë infrastrukturore'* e cila është një kontribut për sforcimin e rrjetit në rrjedhën e sipërme (ujore) ose në rrjedhën e poshtme (ujërat e ndotura) që i atribuohet zgjerimit të shërbimit e që rezulton nga konsumatorët e rinj dhe që imponohet në mënyrë efektive si një shtesë në tarifën e lidhjes. **Shënim: terminologjia 'tarifa për infrastrukturën' siç përdoret në MB mund të rezultojë në një shkallë konfuzioni në Kosovë ku mund të ngatërrohet me 'tarifën e zhvillimit të infrastrukturës' komunale e cila ka të bëjë me infrastrukturën terciare në terren (rrugët, kanalizimi dhe ndriçimi) e cila mbështet drejtpërdrejt ndërtimet e reja dhe nuk i referohet investimeve në infrastrukturë në largësi. Për të shmangur konfuzionin, ARRU i referohet kësaj tarife si *'taksa infrastrukturore e mbingarkesës'*.**

8.9 *'Tarifa e infrastrukturës' në Mbretërinë e Bashkuar (në Kosovë 'tarifa infrastrukturore e mbi ngarkesës'* nuk zbatohet për investimet në vepra të reja trajtimi pasi që kjo automatikisht do të kalojë te konsumatorët e rinj në tarifë mbi bazën se sa më shumë që konsumatorët e rinj i shtojnë kërkesat, aq më shumë do të paguajnë për koston e prodhimit si tarifë për m<sup>3</sup>. Tarifa ka të bëjë vetëm me sforcimin e rrjetit. Për shumë vite tarifa e infrastrukturës ishte përcaktuar në mënyrë arbitrare nga rregullatori dhe ishte e njëjtë në të gjithë Anglinë dhe në Uells. Që nga ajo kohë përcaktimi i saj i është kaluar kompanive të ujit. Kjo tarifë lidhet me një kosto të pakët afatgjatë të përforsimit të rrjetit dhe variron nga kompania e ujit. Tabela 3e ilustron gamën e tarifave të infrastrukturës të aplikuara në MB.

**Tabela 3– Shembull i tarifave të infrastrukturës të aplikuara nga kompanitë e ujit në Angli dhe Uells, MB**

Kompania e ujit	Tarifa e infrastrukturës së ujit për një banesë të re (EUR)	Tarifa e infrastrukturës për ujërat e ndotura për një banesë të re (EUR)
Kompania e Ujit Northumbrian	150-160	110
Kompania e Ujit Severn Trent	420	340
Kompania e Ujit Thames	760	440
Kompania e Ujit Wessex	230	380 - 760

8.10 ARRU konsideron se nivelet domethënëse të zhvillimit të banesave të reja në Kosovë imponojnë vendosjen e *'tarifa infrastrukturore e mbi ngarkesës'* që do t'u vendosen ndërtuesve si një kontribut në drejtim të përforsimit të rrjetit. Të ardhurat nga këto tarifa do të kreditohen kundrejt të ardhurave të kërkuara dhe në këtë mënyrë tarifat për konsumatorët ekzistues do të ulen.

## 8.2 Opsioni –'tarifa infrastrukturore e mbi ngarkesës' për një banesë plus një tarifë e vlerësuar për ndërtimet e reja jo shtëpiake bazuar në ekuivalentët e banimit

### Propozimi

8.11 ARRU propozon të vendosë *'tarifa infrastrukturore të mbi ngarkesës'* për të gjitha ndërtimet e reja për furnizimin me ujë dhe lidhjet e ujërave të ndotura.

8.12 Këto tarifa do të zbatohen për të gjitha vendbanimet e reja neto. Për shembull, nëse një zhvillues rrëzon një bllok të vogël apartamentesh prej 10 banesave dhe e zëvendëson atë me një bllok të ri me 25 banesa, atëherë tarifa e infrastrukturës e vendosur ndaj zhvilluesit do të jetë e barabartë me tarifën për banesë x 15 (jo 25 pasi që zhvillimi imponon vetëm kërkesën shtesë nga vetëm 15 banesa). Ndërtuesi megjithatë do të duhej të paguante për 25 tarifa lidhjeje, duke përfshirë ujëmatësit e lidhjeve etj.

8.13 Një përlllogaritje e thjeshtuar sugjeron se plani i mëposhtëm i tarifave për *'tarifa infrastrukturore e mbi ngarkesës'* do të ishte i përshtatshëm për t'u vendosur për ndërtuesit e pronave përveç tarifave të lidhjes (Tabela 4)<sup>8</sup>.

<sup>8</sup>Përcaktimi me saktësi i një 'tarife për përforsimin e infrastrukturës në largësi' në Kosovë që reflekton kërkesat për përforsim të rrjetit do të jetë një llogaritje komplekse. Kjo kërkon analiza të detajuara inxhinierike dhe llogaritje komplekse të



Tabela 4– tarifat e propozuara për përforcimin e rrjetit në largësi

Shërbimi	Tarifa e përforcimit të rrjetit në largësi për banesë të re (EUR)
Furnizim me ujë	110
Ujërat e ndotura	90

Një opsion i kontabilitetit është të konsiderohen të ardhurat nga këto tarifa si investim i financuar nga granti për të financuar rritjen e infrastrukturës dhe kështu të mos shtohen në BRRRA (Baza Rregullatore e Aseteve). Në mënyrë alternative, të ardhurat mund të kreditohen kundrejt kërkesës së të ardhurave, por çdo investim në përforcimin e rrjetit do të shtohet në BRRRA.

#### Vlerësimi i ndikimit

- 8.14 Sipas kornizës aktuale, kostot nga 'tarifa infrastrukturore e mbi ngarkesës shpërndahen te të gjithë konsumatorët, gjë të cilën ARRU e konsideron të jetë e padrejtë. Shkalla në të cilën konsumatorët ekzistues financojnë sforcimin e rrjetit varet nga numri i pronave të reja. Ndikimi në tarifën për konsumatorët ekzistues do të varet nga mënyra se si trajtohen të ardhurat, qoftë si një kontribut granti për rinovimin e infrastrukturës ose si një kredi kundrejt kërkesës së të ardhurave. Për të ilustruar ndikimin nëse supozojmë se gjatë një periudhe trevjeçare numri i konsumatorëve shtëpiak rritet me 10% dhe tarifa e kombinuar e sforcimit të rrjetit të ujit dhe ujërave të ndotura në largësi është 200 euro. Përfitimi për konsumatorët do të jetë qoftë:
- 0.91 euro për një konsumator në vit në mënyrë të përhershme (duke supozuar një kthim në kapital prej 5%) nëse trajtohet si një kontribut granti, ose
  - 6.06 euro për një konsumator në vit, por që kufizohet në tre vitet e procesit tarifar nëse zbritet nga kërkesa e të ardhurave.

#### Këndvështrimi i ARRU-së

- 8.15 ARRU e konsideron miratimin e tarifës infrastrukturore të mbi ngarkesës si një sistem më të drejtë, pasi që siguron që përgjegjësitë që imponojnë kostot e KRU-së të financojnë sforcimin e rrjetit.
- 8.16 ARRU është e pavendosur se si t'i trajtojmë të ardhurat nga këto tarifa. Në ekuilibër, ARRU anon në favor të thjeshtë të zbritjes së tarifave nga kërkesa e të ardhurave pasi që kjo do të ketë një përfitim të rëndësishëm afatshkurtër për konsumatorët, i cili mund të jetë i preferueshëm kundrejt përfitimeve afatgjata (të përhershme) të konsiderimit të tij si financim granti drejt rritjes së infrastrukturës. Kërkojmë opinione për këtë çështje.

kostos marginale afatgjatë. Kostoja për një banesë të re mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme për çdo KRU dhe sipas sistemeve brenda çdo KRU. Kërkohet një metodë më e thjeshtë.

Në kohën kur u përcaktua hapja e RAB (2008) ARRU (ZRRUM në atë kohë) arriti në vlerën 200 euro për kyçje për ujë dhe 100 euro për ujëra të ndotura. Në nivelet e çmimeve të vitit 2023, këto vlera janë përkatësisht 288 dhe 144 euro. Nëse konsumatorët jo shtëpiak konvertohen në numra ekuivalent shtëpiak në proporcion me normat e rrjedhës, vlerat e hapjes së ekuivalentit shtëpiak do të jenë më të ulëta. Analiza jonë vlerëson se këto vlera duhet të përshtaten në 260 euro dhe 130 euro për furnizimin me ujë dhe ujërat e ndotura përkatësisht për një pronë tipike shtëpiake.

Për furnizimin me ujë, asetet e rrjetit përbënin afërsisht 70% të totalit të RAB. Prandaj, një RAB hapës për asetet e infrastrukturës ujore për një pronë shtëpiake (në nivelet e çmimeve të vitit 2023) do të ishte 0.7 x 230 euro = 161 euro për ekuivalentin e banesës. Për ujërat e ndotura kishte shumë pak asetet të lidhura me trajtimin dhe kur u krijua RAB-i hapës i dha një RAB-it vlerën prej 130 euro për asetet e infrastrukturës së ujërave të ndotura për ekuivalentin e banesës.

Këto vlera lidhen me të gjitha asetet e infrastrukturës së rrjetit duke përfshirë rrjetet terciare të cilat një zhvillues do t'i financonte drejtpërdrejt. Është pothuajse e pamundur të ndahen vlerat e RAB-it të rrjetit ndërmjet asaj parësore dhe terciare, kështu që një supozim i thjeshtë arbitrar është i nevojshëm, p.sh. supozojmë se rrjetet terciare përbëjnë 30% të vlerave totale të rrjetit. Prandaj, RAB-I hapës (nivelet e çmimeve 2023) për rrjetet jo terciare do të ishte në shtrirjen prej 0.7 x 161 euro = 113 euro për furnizimin me ujë dhe 0.7 x 130 euro = 91 euro për ujërat e ndotura.

### 8.3 Pyetje

28. A pajtoheni që aplikimi i 'tarifës infrastrukturore të mbi ngarkesës është një mënyrë e drejtë për të financuar sforcimin e rrjetit që shkaktohet nga ndërtimi i ri? Nëse jo jepni arsyet tuaja.
29. A pajtoheni me propozimet tona për tarifën, përkatësisht 110.00 euro dhe 90.00 euro neto për një lidhje të re të ujit dhe ujërave të ndotura?
30. A mendoni se është e preferueshme që konsumatorët ekzistues të kenë një përfitim më të vogël në mënyrë të përhershme apo një përfitim më të madh, por të kufizuar në vetëm tri vitet e një periudhe procesit tarifor?

## 9 Kosto reflektive – tarifatat e vlerësuara të ujërave të ndotura

### 9.1 Çështja

- 9.1 Korniza aktuale tarifore e ujërave të ndotura përcakton tarifatat e ujërave të ndotura si tarifë për m<sup>3</sup> të ujit të shitur. Pothuajse për të gjithë konsumatorët kjo është arsye racionale pasi që ujërat e ndotura të gjeneruara fillimisht janë marrë nga ujësjellësi i KRU-ve, d.m.th. sa më shumë ujë të konsumohet aq më shumë ujëra të ndotura do të krijohen.
- 9.2 Kemi vënë re se mund të ketë disa konsumatorë të cilët kanë qasje në burime alternative ose shtesë të ujit (furnizim nga puset ose burimet e tjera) dhe ujërat e ndotura të prodhuara prej tyre nuk janë në funksion të ujit të shitur të KRU-ve<sup>9</sup>. ARRU konsideron se kjo duhet të korrigjohet sa më parë.

### 9.2 Opsioni – parashikimi që konsumatorët e caktuar të kenë tarifatat e tyre të ujërave të ndotura të bazuar në tarifatat e vlerësuara kur vëllimi i ujërave të ndotura nuk është i ndërlidhur me ujin e furnizuar nga KRU

#### Propozimi

- 9.3 ARRU propozon të futet në përdorim koncepti i tarifave të vlerësuara ku konsumatorët specifikë tarifohen sipas vëllimit të ujërave të ndotura të gjeneruara pavarësisht nga vëllimi i ujit të furnizuar. Kjo do të kërkojë që KRU-të të vlerësojnë vëllimin e ujërave të ndotura nga konsumatorët e caktuar përmes matjes dhe/ose metodave të tjera.

#### Vlerësimi i ndikimit

- 9.4 Tarifa e vlerësuar e pagesës nuk do të jetë e njëjtë me tarifën e furnizimit me ujë për shkak të faktorëve të kthimit (jo i gjithë uji i marrë shkon në ujëra të ndotura). ARRU vlerëson se tarifa për një pagesë të vlerësuar do të jetë rreth 10% deri në 20% më e lartë se tarifa e bazuar në ujin e marrë.
- 9.5 ARRU supozon se ata konsumatorë që do të duhej të kishin një tarifë të vlerësuar aktualisht po paguajnë më pak se sa duhet. Çdo korrigjim në këtë drejtim do të rezultojë në një ulje të tarifave për të gjithë konsumatorët e tjerë.
- 9.6 Meqenëse numri i konsumatorëve që do t'i nënshtroheshin një tarife të vlerësuar është ndoshta shumë i vogël, ndikimi neto në të gjithë konsumatorët e tjerë do të jetë i vogël, por gjithsesi i dobishëm.

#### Këndvështrimi i ARRU-së

- 9.7 ARRU nuk sheh arsye që të mos vazhdojmë me lejimin e KRU-ve që të vendosin tarifa të vlerësuara për konsumatorët specifikë ku tarifatat e bazuara në ujin e furnizuar nuk janë të përshtatshme.

### 9.3 Pyetje

31. A jeni të pajtimit që konsumatorët e veçantë duhet t'i nënshtrohen tarifave të vlerësuara të ujërave të ndotura kur ujërat e ndotura të shkarkuara nga ta nuk janë të lidhura me furnizimin e ujit? Nëse jo jepni arsyet tuaja.

<sup>9</sup>Ne gjithashtu jemi të vetëdijshëm se disa industri të përpunimit të ushqimit gjenerojnë vëllime të larta të ujërave të ndotura ku ujërat e ndotura janë produkt i biznesit të tyre dhe nuk kanë origjinën nga furnizimi i KRU-së, p.sh. qumështi që përpunohet në djathë dhe hirra që shkarkohen si ujëra të ndotura.

## 10 Kosto reflektive– tarifat e ujërave të ndotura bazuar në vëllimin dhe cilësinë e shkarkimeve të ujërave të ndotura

### 10.1 Çështje

- 10.1 Për shumicën e KRU-ve, ujërat e ndotura derdhen në rrjetin e kanalizimit dhe përfundimisht shkarkohen në mjedis pa trajtim. Kjo mangësi po trajtohet me investime domethënëse në trajtimin e ujërave të ndotura në zhvillim e sipër apo në planifikim.
- 10.2 Kostot ekonomike të kësaj praktike janë të papërcaktuara, por qeveria pranon se dëmi që rezulton ndaj mjedisit duhet të minimizohet aty ku është e mundur. *MMPH 30/2014 Mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor* përcakton standardet për cilësinë e shkarkimeve të ujërave të ndotura dhe vendos kufij për përmbajtjen e mbetjeve të konsumatorëve komercialë (kërkesa biokimike për oksigjen (BOD), materiet e suspenduara (SS) si dhe parametrat e tjerë). Këto standarde i detyrojnë konsumatorët të para-trajtojnë efluentet e tyre përpara shkarkimit në rrjet nëse efluentet e tyre i tejkalojnë këto standarde.
- 10.3 Në praktikë, këto standarde nuk respektohen dhe zbatimi është i kufizuar. Për më tepër, vendosja e gjithëpërfshirëse e standardeve të tilla mund të mos jetë qasja ekonomikisht më efikase. Për shembull, nëse efluenti i një konsumatori tejkalon standardet dhe është më e lirë për KRU-në që t'i trajtojë ato ujëra të ndotura sesa që konsumatori të investojë në trajtimin paraprak, atëherë vendimi ekonomikisht më efikas i atij konsumatori është që të mos investojë në trajtimin paraprak, por në vend të kësaj ta paguajë KRU që ta bëjë këtë. Nëse KRU-së i kushton më shumë trajtimi dhe këto kosto do t'i barten konsumatorit, atëherë vendimi ekonomikisht efikas i konsumatorit do të ishte investimi në trajtimin paraprak.
- 10.4 Politika aktuale tarifore e ARRU-s përcakton tarifën për ujërat e ndotura bazuar në kërkesat për të ardhura për ofrimin e shërbimeve të ujërave të ndotura (kostot operative, mirëmbajtja kapitale dhe kthimi në kapital). Këto kosto konvertohen në një tarifë për m<sup>3</sup> uji të shitur, me vëllimin e ujit i cili përdoret si zëvendësues për vëllimin e shkarkimit të ujërave të ndotura.
- 10.5 Politika gjithashtu parasheh një ndër-subvencionim midis grupeve të konsumatorëve, përgjithësisht konsumatorët jo shtëpiak paguajnë pothuajse dy herë më shumë për m<sup>3</sup> ujë të shitur sesa konsumatorët shtëpiak. Ky ndër-subvencionim fillimisht u perceptua si i justifikuar mbi bazën se konsumatorët jo shtëpiak mund të jenë më ndotës se konsumatorët shtëpiak dhe kështu imponojnë më shumë kosto në sistemet dhe rrjetet e trajtimit. Hulumtimet pasuese për karakteristikat e cilësisë së ujërave të ndotura shpalosin se ky supozim nuk është domosdoshmërisht i vërtetë dhe megjithëse disa konsumatorë, p.sh. fabrikat e birrës dhe industritë e përpunimit të ushqimit mund të prodhojnë ujëra të ndotura të nivelit të lartë ndotës, shumica e konsumatorëve jo-shtëpiak prodhojnë ujëra të ndotura që janë të ngjashme me ujërat e ndotura shtëpiake, p.sh. qendrat tregtare etj.
- 10.6 Posaçërisht për ata përdorues, ujërat e ndotura të cilëve janë në mënyrë domethënëse më ndotëse, ARRU konsideron se duke vendosur tarifën e njëjtë si për të gjithë konsumatorët e tjerë rezulton që ata të tarifohen më pak se kostot që ata krijojnë dhe konsumatorët e mbetur të tarifohen më shumë, që në mënyrë efektive është një ndërsubvencionim nga konsumatorët shtëpiak dhe jo-shtëpiak tek konsumatorët specifik industrialë. Megjithëse konsumatori mund të mos penalizohet nga autoritetet mjedisore për mospërputhje me standardet, KRU-të duhet të kenë të drejtë ta ngarkojnë konsumatorin për kostot të cilat ia krijon KRU-së.
- 10.7 Aktualisht, konsumatorët industrialë me ujëra të ndotura që janë ndotëse në masë të lartë janë të dekurajuar që të investojnë në trajtimin paraprak pasi është më e lirë për ta që të vazhdojnë t'ia lejnë KRU-ve që të trajtojnë ujërat e tyre të ndotura me një çmim që është më i ulët se kostot e imponuara KRU-ve.
- 10.8 Kjo adresohet nga shumë shërbime komunale dhe rregullatorë në mbarë botën me përdorimin e formulës Mogden e cila përcakton tarifa për konsumatorët specifikë sipas cilësisë së ujërave të ndotura dhe vëllimit të tyre. Tarifën e cilësisë vendosen për të pasqyruar kostot e trajtimit të ujërave të ndotura dhe në këtë mënyrë konsumatorët industrialë inkurajohen të investojnë në trajtimin paraprak, por

vetëm kur është ekonomikisht efikase për ta bërë këtë. Varësisht nëse kostoja e trajtimit paraprak të përhershëm është më e vogël se tarifat shtesë që rezultojnë nga formula Mogden, industria do të zgjedhë të investojë dhe anasjelltas.

- 10.9 Në mënyrë që konsumatorët të përgjigjen në mënyrë efikase, tarifat duhet të reflektojnë koston dhe të mos përfshijnë ndonjë shtrembërim. Për shembull, nëse një konsumator instalon para-trajtimin, ulja e tarifave duhet të pasqyrojë kursimet në kosto të cilat i ofron trajtimi paraprak. Kjo nuk duhet të shtrembërohet nga përshtatjet për të përmbushur kërkesat e mbulimit të koston, veçanërisht çdo shtrembërim të krijuar nëpërmjet investimeve të financuara nga grantet dhe ndërsbvencionet.
- 10.10 Meqenëse kërkesa totale e të ardhurave është e pandryshuar, çdo e ardhur shtesë e cila rezulton nga tarifat shtesë të cilësisë së ujërave të ndotura do të përdoret për të ulur tarifat e ujërave të ndotura për të gjithë konsumatorët e tjerë.
- 10.11 ARRU konsideron se miratimi i formulës Mogden për një numër të kufizuar të konsumatorëve në Kosovë, do të sigurojë përmirësim të koston reflektive për të gjithë konsumatorët.

## 10.2 Opsioni – prezantimi/futja në përdorim e tarifave të bazuara në cilësi për konsumatorët e veçantë jo shtëpiak

### Propozimi

- 10.12 ARRU propozon të lejojë KRU-të të vendosin tarifa të bazuara në cilësi për konsumatorët industrialë kur ata besojnë se cilësia e ujërave të ndotura që shkarkohen është në mënyrë materiale e ndryshme nga ujërat e ndotura shtëpiake. Kjo nuk do të zbatohet për blloqet e zyrave, qendrat tregtare, bizneset e vogla etj. Kjo do të zbatohet vetëm për konsumatorët e mëdhenj industriale ku cilësia e ujërave të ndotura është në mënyrë materiale e ndryshme nga ujërat e ndotura shtëpiake, p.sh. fabrikat e birrës, të përpunimit të ushqimit etj., dhe se ato janë të madhësisë së mjaftueshme të jenë në gjendje t'i përgjigjen sinjaleve të çmimeve duke marrë parasysh trajtimin paraprak të ujërave të ndotura të tyre dhe në këtë mënyrë të reduktojnë tarifat e tyre.
- 10.13 ARRU ka ekzaminuar bazën e konsumatorëve për të gjitha KRU-të dhe ka shumë pak industri ku besojmë se kjo do të zbatohet. Rrjedhimisht, konsiderojmë se vendimi për aplikimin e tarifave të bazuara në cilësi duhet t'i përket KRU-ve që ta përcaktojnë. ARRU do të inkurajojë KRU-të që të aplikojnë tarifa të bazuara në cilësi aty ku është e përshtatshme. Nuk do të jetë obligative. Nëse një KRU konsideron se ka shumë pak ose fare nuk ka konsumatorë industrialë në zonën e tyre të furnizimit dhe se cilësia e ujërave të ndotura nuk është në mënyrë materiale e ndryshme nga ujërat e ndotura shtëpiake, ato nuk duhet të detyrohen ta miratojnë këtë proces.
- 10.14 Metoda të cilën ARRU e propozon është formula Mogden e cila merr në konsideratë koston e trajtimit për dy parametra kryesorë, kërkesën biokimike për oksigjen (BOD) dhe materiet e suspenduara (SS) pasi këta dy parametra kontribuojnë në pjesën më të madhe të kostove të trajtimit të ujërave të ndotura.
- 10.15 Në këtë kohë, ARRU propozon që tarifimi i bazuar në cilësi të zbatohet vetëm për konsumatorët më të mëdhenj industrialë ku ka mundësi që ata t'i përgjigjen sinjaleve të çmimeve. Megjithatë është e mundur të futet në përdorim tarifat e bazuara në cilësi për konsumatorët e vegjël duke përdorur parametrat e supozuar të cilësisë, ARRU konsideron se ndikimi neto në çmimet në përgjithësi do të jetë minimal dhe se përfitimet ka mundësi të jenë shumë më të vogla se koston administrative dhe koston e tjera të cilat lidhen me zbatimin e tij.
- 10.16 Në mënyrë që tarifat e bazuara në cilësi të aplikohen në mënyrë efektive, KRU-ve mund t'ju duhet t'u caktohen më shumë kompetenca sesa gëzojnë aktualisht, veçanërisht të drejtat që ndërliken me inspektimet në terren. Atyre gjithashtu duhet t'u ofrohen kompetenca shumë më të forta përmbartimore ndaj konsumatorëve të cilët zbulohet se shkarkojnë ujëra të ndotura, që janë jashtë parametrave të përcaktuara të cilësisë së ujit dhe që në raste ekstreme të jenë në gjendje t'u lëshojnë për ekzekutim për ta që ta ndërpresin shkarkimin në sistem deri në momentin kur ujërat e ndotura të jenë sjellë brenda standardeve të lejuara. Për t'u mbrojtur nga konsumatorët që vazhdimisht shkarkojnë ujëra të ndotura përtej standardeve të lejuara, legjisllacioni duhet t'i detyrojë KRU-të të kenë

kompetenca që të informojnë autoritetet përkatëse të mbrojtjes së mjedisit për çdo shkelje mjedisore, në mënyrë që ato të jenë të vetëdijshme për çdo incident të mundshëm të ndotjes së mjedisit.

- 10.17 Aktualisht Kosova ka pak impiante për trajtimin e ujërave të ndotura edhe pse kjo pritet të rritet me shpejtësi gjatë dhjetë viteve të ardhshme. Ekzistojnë dy mundësi zbatimi të tarifimit të bazuar në cilësi në këtë mjedis operativ:
1. Zbatimi i tarifës së bazuar në cilësi vetëm për ata konsumatorë, ujërat e ndotura të të cilëve përfundimisht i nënshtrohen trajtimit, por jo për ata konsumatorë, ujërat e ndotura të të cilëve përfundimisht shkarkohen në mjedis pa trajtim mbi bazën se mund të imponohen vetëm për të reflektuar kostot për KRU-të, por jo ndaj mjedisit.
  2. Zbatimi i tarifës së bazuar në cilësi për të gjithë konsumatorët me arsyetimin se është në përputhje me parimin *ndotësi paguan*. Edhe nëse ujërat e ndotura nuk trajtohen, tarifata shtesë do të reflektojnë dëmin relativ që efluentet ia imponojnë mjedisit. Kjo është në harmoni me politikën ekzistuese të tarifave uniforme në të gjithë zonën e shërbimit.
- 10.18 Opsioni 1 i mësipërm do të rezultojë në çmime diskriminuese brenda secilës zone të shërbimit të KRU-ve, në kundërshtim me politikën aktuale të tarifave uniforme brenda një zone shërbimi, p.sh. dy konsumatorë identikë mund të përballen me tarifa të ndryshme varësisht nga fakti nëse ujërat e ndotura të tyre i nënshtrohen apo jo trajtimit. Opsioni 2, nga ana tjetër, është në përputhje me politikën aktuale të tarifave uniforme dhe e plotëson parimin ndotësi paguan. Megjithatë, ai mund të jetë objekt i kundërshtimit ligjor me argumentin se ata konsumatorë, ujërat e ndotura të të cilëve nuk janë objekt i trajtimit nuk duhet të kenë tarifa më të larta nëse nuk imponojnë ndonjë kosto shtesë në sistemet e KRU-ve.
- 10.19 Në afat të gjatë do të pritet të trajtohen të gjitha ujërat e ndotura të konsumatorëve të cilat derdhen në rrjetet e KRU-ve. Prandaj, të gjithë konsumatorët industrialë të prekur duhet t'i nënshtrohen të njëjtave sinjale ekonomike për të inkurajuar investime efikase sa më shpejt që të jetë e mundur.

#### Vlerësimi i ndikimit

- 10.20 Ndikimi tek konsumatorët shtëpiak dhe jo shtëpiak nuk do të jetë i njëjtë kudo dhe do të varet nga karakteristikat specifike e konsumatorëve industrialë për të cilët do të aplikohet.
- 10.21 ARRU parashikon që tarifata e bazuara në cilësi të ujërave të ndotura do të zbatohen vetëm për një ose dy KRU pasi që shumica e KRU-ve nuk kanë konsumatorë të mëdhenj industrialë me ujëra të ndotura të cilat janë në mënyrë materiale më ndotëse se ujërat e ndotura shtëpiake.
- 10.22 Aty ku zbatohet do të ketë për efekt rritjen e tarifave për konsumatorin industrial të prekur dhe uljen e tarifave për të gjithë konsumatorët e tjerë, përfshirë konsumatorët shtëpiak.
- 10.23 ARRU ka pranuar analizën nga një KRU me konsumator të madh industrial e cila sugjeron që tarifa e ujërave të ndotura të këtij konsumatori të rritet mbi 50% dhe tarifata për të gjithë përdoruesit e tjerë do të ulen mbi 25%. Ky shembull është i jashtëzakonshëm dhe kur zbatohet diku tjetër ne do të prisnim që efekti të jetë më i vogël.
- 10.24 Tarifata e bazuara në cilësinë e ujërave të ndotura varet nga qasja e KRU-ve në laboratorët e testimit të cilësisë së ujërave të ndotura që posedojnë staf profesional. Kjo kërkon investime kapitale dhe njerëzore.
- 10.25 Konsumatorëve industrialë mund t'u kërkohet të matin vëllimin e ujërave të ndotura të tyre. Konsumatorët e prekur, ndoshta nën drejtimin e KRU-ve do të duhet të blejnë dhe instalojnë pajisjet e nevojshme matëse.

#### Këndvështrimi i ARRU-së

- 10.26 ARRU konsideron se tarifata e bazuara në cilësi duhet të jenë të lejueshme dhe të zbatohen në bazë të diskrecionit të KRU-ve. Kur ata të dorëzojnë aplikacionet tarifore në ARRU, ARRU do të kërkojë nga KRU-të që të ofrojnë dëshmi se tarifata e përcaktuara e reflektojnë koston.

- 10.27 E rëndësishme në këtë propozim është që tarifat e bazuara në cilësi të mos konsiderohen si të ardhura shtesë, por më tepër si një rishpërndarje e të ardhurave nga tarifat të cilat rriten për disa konsumatorë dhe ulën për pjesën tjetër. Kërkesa për të ardhura në planin e biznesit është e pandryshuar.
- 10.28 Për të zbatuar këtë propozim, ARRU do të lëshojë udhëzime për KRU-të në formën e një shënimi udhëzues që do t'i këshillojë ata se si duhet të përcaktohen tarifat dhe për përshtatjet që do të duhet t'i bëjnë në të gjitha tarifat. Ky udhëzim do të përfshijë rregulla se si t'iu përgjigjemi rrethanave të cilat ndryshojnë, p.sh. instalimi i trajtimit paraprak brenda një periudhe të rishikimit tarifor.

### 10.3 Pyetje

32. A jeni të pajtimit se tarifat e bazuara në cilësi për konsumatorët më të mëdhenj industrialë ndikon në koston reflektive dhe një mënyrë më të drejtë për të shpërndarë tarifat në bazën e konsumatorëve? Nëse jo jepni arsyet tuaja.
33. A pajtoheni që zbatimi i tarifave të bazuara në cilësi duhet të kufizohet në radhë të parë vetëm për përdoruesit më të mëdhenj industrialë dhe se tarifat e bazuara në cilësi për konsumatorët më të vegjël duhet të shtyhen për të ardhmen?
34. A pajtoheni që miratimi i tarifave të bazuara në cilësi duhet të jetë në diskrecionin e KRU-ve apo duhet të jetë i obligueshëm për të gjitha KRU-të?
35. A pajtoheni që tarifat e bazuara në cilësi duhet të aplikohen pavarësisht nëse ujërat e ndotura i nënshtrohen trajtimit, si një mjet për dërgimin e sinjaleve të çmimeve ekonomike tek konsumatorët për të trajtuar paraprakisht ujërat e tyre të ndotura dhe si një reflektim i koston së dëmtimit të mjedisit?
36. A keni ndonjë mendim tjetër për tarifimin e bazuar në cilësi për shërbimet e ujërave të ndotura?

## 11 Mbrojtja e konsumatorëve të cenueshëm

### 11.1 Çështja

- 11.1 Analiza shpalos se koeficienti ekzistues i ndërsubvencionimit është një mekanizëm joefikas për t'iu ofruar mbështetje familjeve të cenueshme, meqë mbi 85% të familjeve vlerësohen të jenë në gjendje t'i përballojnë faturat e ujit nëse hiqet subvencioni. Vlera e subvencionit është e barabartë me rreth 6.00 euro për familje, duke supozuar nivelet minimale të konsumit të nevojave bazë. Përfitimi është edhe më i lartë për familjet më të pasura, të cilat gëzon tarifa më të ulëta aktualisht me c' rast ndikon në rritjen e sasisë së ujit të konsumuar.. ARRU vlerëson se 83% e vlerës totale të subvencionit shkon për familjet të cilat nuk kanë nevojë për të (sipas kësaj analize). Për ata që kanë nevojë për mbështetje, subvencioni është i pamjaftueshëm me një mungesë mesatare prej 16 eurove në vit për 15% të atyre të cilët do të kishin vështirësi të përballonin faturat e tyre të ujit dhe ujërave të ndotura (sipas kësaj analize).
- 11.2 ARRU e kupton se disa familje mund të kenë nevojë për mbështetje që u drejtohet atyre dhe jo të gjithë konsumatorëve.

### 11.2 Opsioni – mbështetje e synuar për familjet e cenueshme

#### Propozimi

- 11.3 Mbështetja e synuar përmes tarifave për të mbështetur familjet e cenueshme.

#### Vlerësimi i ndikimit

- 11.4 ARRU vlerëson se konsumatorët më të mëdhenj, janë ata që do të preken më shumë, ku konsumi i ujit mund të jetë pashmangshmërisht i lartë, por të ardhurat mund të jenë të ulëta. Sidoqoftë, analiza jonë tregon se edhe në mesin e familjeve të mëdha me pesë ose më tepër persona, kufizimet e përballueshmërisë prekin vetëm rreth 20% të familjeve të tilla. Rrjedhimisht, mbështetja e shënjestruar në bazë të madhësisë së familjes apo të numrit të fëmijëve do të rezultojë ende në gabime të rëndësishme të përfshirjes.
- 11.5 ARRU ka hulumtuar opsione të tjera për të shënjestruar në mënyrë efektive mbështetjen e familjet e cenueshme, por nuk jemi në gjendje të identifikojmë ndonjë mënyrë e cila mund të konsiderohet efikase.

#### Këndvështrimi i ARRU-së

- 11.6 ARRU ka arritur në përfundimin se një zgjidhje e bazuar në tarifa për të shënjestruar konsumatorët e cenueshëm të ndihmohen rreth faturave të ujit dhe ujërave të ndotura nuk është e përshtatshme. Identifikimi i atyre të cilët kanë nevojë për mbështetje do të jetë përplot me vështirësi dhe ARRU nuk mendon se kjo duhet t'i përket KRU-ve që ta përcaktojnë atë. ARRU konsideron se ofrimi i mbështetjes financiare për familjet në nevojë nuk është përgjegjësi e shërbimit të ujësjellësit, por e qeverisë nëpërmjet skemës së ndihmës sociale.
- 11.7 Prandaj ARRU konkludon se nuk duhet të përfshijë masa specifike në metodologjinë e përcaktimit të tarifave për t'u kujdesur për konsumatorët e cenueshëm.

### 11.3 Pyetje

37. A jeni të pajtimit se përgjegjësia për të mbështetur konsumatorët e cenueshëm nuk duhet t'i ngarkohet qeverisë pasi ata janë në pozicion më të mirë për të identifikuar këto nevoja dhe për të ofruar mbështetjen në mënyrë më efektive sesa që mund të ofrohet përmes tarifave? Nëse jo jepni arsyet tuaja.
38. A keni ndonjë sugjerim se si mund të mbështeten më të cenuarit në shoqëri rreth faturave të ujit dhe ujërave të ndotura?